



# PLAN

për zhvillim të qëndrueshëm.

Shtylla I / 1

## INVESTIMI PËR TË ARDHMEN

Analizë politikash në mbështetje të  
procesit të elaborimit të SKZH-së

Zyra për Planifikim Strategjik  
e Zyrës së Kryeministrit





# PLAN

për zhvillim të qëndrueshëm.

---

Shtylla I / 1

## INVESTIMI PËR TË ARDHMEN

Analizë politikash në mbështetje të  
procesit të elaborimit të SKZH-së

Zyra për Planifikim Strategjik  
e Zyrës së Kryeministrit

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	4
Thekset kryesore nga kjo analizë .....	5
Qëllimi .....	6
Arsyetimi .....	6
Dokument i Politikave: qëllimi dhe qasja.....	6
Reformat në arsimin themelor dhe ndikimi i tyre në cilësi: mësimet nga praktikat ndërkombëtare .....	7
Variablat që ndikojnë në cilësinë e arsimit .....	7
Çfarë bëjnë sistemet e avancuara të arsimit për të përmirësuar performancën? .....	8
Struktura dhe performanca e Arsimit Para-Universitar të Kosovës .....	10
Struktura e arsimit të Kosovës .....	10
Performanca e Arsimit para-universitar të Kosovës.....	11
Përmbledhje e problemit .....	11
Problem statement .....	13
Përmbajtja dhe Burimet e Arsimit.....	16
Korniza e Kurikulës dhe Standardet .....	16
Teknologjia informative dhe e komunikimit.....	16
Mësimdhënësit në Kosovë .....	17
Kuadri i mësimdhënësve sipas gjinisë dhe moshës .....	17
Kualifikimet e mësimdhënësve .....	18
Zhvillimi profesional i mësimdhënësve .....	20
Vlerësimi i performancës dhe licencimi i mësimdhënësve .....	21
Pagesa e mësimdhënësve dhe kushtet e punës.....	21
Sistemi i llogaridhënies .....	22
Ekzaminimi i jashtëm i studentëve/nxënësve.....	22
Vlerësimet e shkollave dhe garantimi i cilësisë .....	23
Masat e rekomanduara të reformës.....	24
Masa 1: Të rritet përfshirja në arsimin para-shkollor dhe para-fillor për të përmirësuar arritshmërinë e nxënësve .....	25
Veprimi 1: Të rritet përfshirja në arsimin para-fillor me 5000 fëmijë shtesë .....	25
Veprimi 2: Të rritet përfshirja në arsimin para-shkollor (3-4 vjeçare) me 5000 fëmijë shtesë.....	26
Masa 2: Ngritja e cilësisë së mësimdhënies për rezultate më të mira të nxënësve.....	27
Veprimi 1: Programi për rikualifikimin e mësimdhënësve.....	27
Veprimi 2: Shfrytëzimi optimal i mësimdhënësve .....	27
Veprimi 3: Skema e pensionimit të hershëm të mësimdhënësve me aftësi të kufizuara .....	27
Veprimi 4: Vlerësimi i performancës dhe sistemi i licencimit të mësimdhënësve .....	28
Masa 3: Rritja e llogaridhënies dhe praktikës së sigurimit të cilësisë .....	29
Veprimi 1: Vlerësimi i shkollave: vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm .....	30
Masa 4: Përmirësimi i burimeve të edukimit dhe integritit i TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie .	31
Tabela e figurave.....	33
Lista e tabelave.....	33
Referencat .....	34

.....

Lista e shkurtesave

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
KPK	Korniza e Përgjithshme e Kurikullës
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TI	Teknologjia Informativë
ISCED	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
KKK	Korniza e Kurikullës së Kosovës
PZHEK	Programi për Zhvillimin e Edukatorëve në Kosovë
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës
DKA	Departamentet Komunale të Arsimit
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PC	Kompjuter Personal
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
SC	Sigurimi i Cilësisë
EJL	Evropa Juglindore
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik

## Thekset kryesore nga kjo analizë

Arsimi para-universitar është me rëndësi themelore për formimin e kapitalit njerëzor meqenëse ai vendos bazat për të gjitha fazat e tjera të zhvillimit njerëzor. Gjatë dekadës së kaluar, ne kemi parë përmirësime të konsiderueshme të infrastrukturës fizike të shkollave dhe nivelit të regjistrimit në shkollat fillore. Janë ndërtuar shumë shkolla dhe shumica dërrmuese e fëmijëve tani janë në klasa dhe jo më në hapësira të improvizuara. Megjithatë, cilësia e arsimit që ata marrin është shqetësuese. Rezultati i Kosovës në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), i nxjerrë nga OECD, vlerësohet me 390 pikë. Praktikisht, kjo nënkupton që pesëmbëdhjetëvjeçarët tanë dinë më pak se në vendet e rajonit sikurse Mali i Zi (për 60 pikë) dhe Sllovenia (për 100 pikë). Performanca e dobët e sistemit të arsimit para-universitar është po ashtu duke dobësuar performancën në nivelet më të larta të arsimit, për shkak se fëmijët shkojnë në shkolla të mesme dhe universitete duke qenë më pak të përgatitur.

- Shumica e mësimdhënësve të arsimit fillor në Kosovë nuk kanë të kryer nivelin baçelor (62 përqind) dhe shumica e atyre në arsimin sekondar janë të pakualifikuar (54 përqind). Studimet konfirmojnë që cilësia e arsimit është faktori më i rëndësishëm që përmirëson rezultatet e nxënësve.
- Përmirësimi i kualitetit të mësimdhënies mund të bëhet duke zhvilluar programe për rikualifikimin e mësimdhënësve, duke siguruar shfrytëzimin më të mirë të mësimdhënësve dhe skema për pensionimin e parakohshëm të mësimdhënësve me aftësi të kufizuara dhe duke ngritur sistemin e vlerësimit të performancës dhe licencimit të mësimdhënësve.
- Kosova ka një nga nivelet më të ulëta të regjistrimit në rajon për sa i përket arsimit parashkollor, me vetëm 26%. Përfshirja në aktivitete parashkollore është me rëndësi vendimtare për performancën më të mirë në fazat e tjera, meqenëse mosha prej 0-6 vit është vendimtare për zhvillimin kognitiv.
- Numri i fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor dhe parafillor mund të rritet duke rishpërndarë mësimdhënësit nga nivelet e larta të shkollave fillore dhe sekondare ku numrat e nxënësve janë në rënie.
- Shkalla kompjuter-nxënës në shkollat e Kosovës është 1:46, jashtëzakonisht më e ulët sesa mesatarja e BE-së, ku një kompjuter është në shërbim të 3-7 studentëve. Madje edhe aty ku ka kompjuterë, mjetet e TIK-ut nuk përdoren për qëllime didaktike.
- Promovimi i përdorimit të TIK në procesin e mësimdhënies nëpër shkolla do të rezultonte në zbatim të kurrikulës së re të Kosovës dhe do të sjellte rezultate më të mira në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo mund të bëhet duke rritur numrin e kompjuterëve për studentët (1 për 10) dhe duke nisur shfrytëzimin e platformave didaktike online në kurrikulum.
- Sistemi i ekzaminimit të jashtëm të nxënësve është ende i pazhvilluar, i mungon kredibiliteti dhe të dhënat nuk janë të besueshme. Inspektimi i shkollave dhe siguria e cilësisë vuajnë nga kapacitetet e dobëta të inspektorateve dhe mungesa e kornizës për vlerësimet e jashtme.
- Rritja e praktikave të llogaridhënies dhe sigurimit të cilësisë do të rezultonte në rezultate më të mira për studentët. Kjo mund të bëhet duke zhvilluar një përgjegjësi të përbashkët ndërmjet inspektorateve të arsimit të komunave dhe qeverisë qendrore dhe duke themeluar një sistem funksional të sigurimit të cilësisë.

---

## Qëllimi

Qeveria e Kosovës ka iniciuar punën në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Kosova 2020. SKZH e Kosovës është një dokument kryesor për vizionin strategjik për zhvillimin e vendit deri në vitin 2020. Ai prioritetizon politikat me qëllim të arritjes së progresit të prekshëm në fushat të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe kohezionin social. Modeli i rritjes ekonomike dhe kohezionit social për Kosovën, i shtjelluar nga ky projekt ka dalë me një listë të prioriteteve potenciale të politikave të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me objektivin strategjik të arritjes së normave vjetore të rritjes prej 7-8% deri në vitin 2020 duke zhbllokuar potencialin ekonomik të punës dhe burimeve natyrore në mënyrë që të maksimizohet prodhimi dhe të zbutet varfëria. Lista e lartpërmendur e prioriteteve të politikave është bazuar në analizën mbi pengesat për zhvillim ekonomik të Kosovës dhe është harmonizuar me prioritetet nga reformat strukturore të identifikuar në kuadër të Programit të Reformave Ekonomike të Republikës së Kosovës.

## Arsyetimi

### Dokument i Politikave: qëllimi dhe qasja

Cilësia e arsimit është një nga përcaktuesit më të rëndësishëm për rritje ekonomike afatgjatë. Përtej rritjes ekonomike, arsimit përmirëson standardet e jetesës së individëve, ngase sa më shumë të edukuar janë në gjendje të marrin me tepër shkathtësi dhe arsytim të nivelit të kartë, duke i bërë ata më produktiv dhe të punësueshëm dhe të zgjerojnë pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës përgjatë tërë jetës, që anën tjetër qon në fitime më të larta dhe cilësi më të mirë të jetës. Arsimit cilësor dhe shkollimi formal po ashtu janë të ndërlidhura me qeveritë demokratike dhe kontribuojnë në shkathtësi socio-emocionale sikurse vëmendja, motivimi, vetëbesimi, dhe shëndeti fizik dhe mendor, të gjitha këto përcaktuar të rëndësishëm për mobilitetin socio ekonomik. Shqyrtimet e politikave në vazhdimësi theksojnë rëndësinë e reformave të politikave në arsimin themelor para-universitar si një hap për rritjen e prodhimtarisë së fuqisë punëtore.

Qeveria e Kosovës ka iniciuar punën në shtjellimin e Strategjisë për Zhvillim Kombëtar (SKZH) Kosova 2020. SKZH-ja e Kosovës është një vizion strategjik themelor për zhvillimin e vendit deri në vitin 2020. Ajo prioritetizon politikat me qëllim të arritjes së progresit të prekshëm në fushat të cilat e pengojnë rritjen ekonomike dhe kohezionin social. Modeli i rritjes ekonomike dhe kohezionit social për Kosovën, i shtjelluar nga ky Projekt, ka paraqitur një listë të politikave potenciale prioritare të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me objektivin strategjik të normave të rritjes vjetore prej 7-8% deri më 2020. Vetëm një rritje e një niveli të tillë mund të zhbllokoj potencialin e fuqisë punëtore dhe burimeve natyrore me qëllim të zbutjes së varfërisë dhe kalimit në një kategori më të ardhura më të larta.

Qëllimi i këtij dokumenti analitik është që të prezantoj praktikrat dhe masat që mund të shërbejnë për të reformuar sektorin e arsimit para-universitar të Kosovës. Qasja e përdorur në këtë dokument është që fillimisht të paraqes variablat kyce individuale, në nivelin shkollor dhe nivelin e sistemit që ndikojnë në performancën e sistemit – pjesa e parë paraqet shtytësit dhe variablat më të rëndësishme të sistemit që ndikojnë në arritshmërisë e nxënësve në cilësime të ndryshme ndërkombëtare. Korniza e analizave bazohet në sistemin e rezultateve (OECD PISA) në vend të sistemit të produktit. Së dyti, dokumenti vendos performancën e arsimit themelor në një kornizë analitike krahasuese duke formuluar përllogaritje të performancës së nxënësve Kosovar në programe ndërkombëtare të testimit dhe duke krahasuar ato me tregues ndërkombëtar të arsimit. Së treti, ky dokument paraqet një vlerësim më të hollësishëm të përbërësve kryesor të arsimit themelor: mësimdhënësve, përmbajtjes arsimor, burimeve të arsimit dhe praktikrat e llogaridhënies/menaxhimit të cilësisë. Në pjesën e fundit liston masat e sugjeruara të reformës dhe intervenimet përkatëse të politikave.

.....

## Reformat në arsimin themelor dhe ndikimi i tyre në cilësi: mësimet nga praktikatat ndërkombëtare

### Variablat që ndikojnë në cilësinë e arsimit

**Raporti nxënës-mësimdhënës dhe madhësia e klasave kanë ndikim të vogël në arritjet e nxënësve** – reduktimi i madhësisë së klasave ka qenë një politikë kyçe e sistemeve ndërkombëtare të arsimit gjatë dekadës së fundit. Arritja e një raporti më të ulët nxënës-mësimdhënës ka qenë një politikë e përkrahur dhe financuar gjerësisht me synim të përmirësimit të arritshmërisë së nxënësve (Sanders, 1996). Secili vend i OECD-së ka rritur numrin e mësimdhënësve në përpjekje për të siguruar një cilësi më të mirë të sistemit. Një politikë e ngjashme ka qenë prioritet në Kosovë si pjesë e Planit Strategjik të Arsimit 2011-2016. Megjithatë, të dhënat e disponueshme dëshmojnë se ulja e madhësisë së klasave dhe raportit ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve nuk kanë ndikim të madh në arritshmërinë e nxënësve dhe cilësi. Nga 112 studime që kanë synuar hulumtimin e ndërlidhjeve të mundshme ndërmjet raportit nxënës-mësimdhënës, 103 nuk kanë gjetur ndonjë ndikim domethënës në rezultatet e ekzaminimit të jashtëm të nxënësve (Scientific America, 2001). Përkundrazi, klasat me madhësi më të vogël kishin implikime të shumta të burimeve dhe kanë prodhuar efekte të pafavorshme. Shkollat më të vogla kërkojnë numër të njëjtë të mësimdhënësve pavarësisht numrit të nxënësve dhe si rezultat sistemet do të kenë më pak fonde për rritjen e pagesave, që e bënë profesionin jo popullor për profesionist me kualifikim të lartë.

**Analiza thekson se statusi socio-ekonomik i nxënësve ka një ndërlidhje të rëndësishme në nivelet e performancës** – ekziston një ndërlidhje e fuqishme ndërmjet nivelit të BPV dhe arritshmërisë së studentëve. Statusi socio-ekonomik i nxënësve është i lidhur me arritje më të larta në testet e vlerësimit të jashtëm për nxënësit që vijnë nga nivele me të ardhura më të larta me ata që vijnë nga familje me të ardhura më të ulëta që është më tepër e pritshme të kenë arritje më të ulët në matematikë, shkencë dhe lexim. Faktor të tjerë të rëndësishëm përfshijnë efektet kryesore negative të të qenit imigrant si dhe hendeku gjinor në aftësitë e të lexuarit.

**Ndjekja e arsimit parafillor për më tepër se një vit ndikon arritshmërinë e nxënësve** – Arsimi parashkollor ka potencial të lehtësoj pabarazitë në jetën e hershme dhe të nivelizoj nivelin e hapësirës së veprimit për student të marginalizuar. Të dhënat nga PISA<sup>1</sup> tregojnë se një fillim i hershëm në shkollën fillore është tepër i ndërlidhur me rezultate më të larta të të lexuarit në arsimin fillor dhe të mesëm. Të dhënat globale tregojnë se sigurimi i cilësisë së arsimit parashkollor është me rëndësi për promovimin e zhvillimit social, emocional, fizik dhe njohës të fëmijëve; gjithashtu rrit gatishmërinë e shkollës, që ndihmon në mësimnxënie (Heckman dhe LaFontaine 2010; Heckman 2008; Engle et al. 2011). Mungesa e shkathtësive njohëse fillon të shfaqet herët dhe pabarazitë për qasje në arsimin parashkollor zgjerojnë hendekun e të mësuarit. Literatura për zbrëthimin e rezultateve të studentëve në PISA përmes grupeve (Amermueller 2004) dhe viteve (Barrera et al. 2011) ka gjetur se performanca e nxënësve në PISA është rritur për 10 pika në PISA për secilin vit të kaluar në arsimin parashkollor.

**Kualifikimi i mësimdhënësve dhe cilësia janë faktor kyç për arritshmërinë e studentëve** – Sipas të dhënave të disponueshme nga praktikatat ndërkombëtare cilësia e mësimdhënësve është shtytësi kryesor i ndryshimit në arritshmërinë e studentëve në nivelin shkollor. Një studim i realizuar në SHBA ka shfaqur se studentët të cilët kanë pasur mësimdhënës me kualifikime të larta kishte mundësi të performojnë tri herë më shpejtë se sa ata që kishin mësimdhënës të pakualifikuar. Ndikimi negativ i mësimdhënësve me performancë të ulët është tepër i madh, në veçanti gjatë viteve të hershme të shkollimit. Studentët të cilët vuajnë humbje të arsimit në vitet e hershme do të kenë vështirësi serioze në aspektin e kundërt në fazat e mëvonshme. Për më tepër, analizimi i rezultateve të PISA në mbarë botën tregon se proporcionin e mësimdhënësve të kualifikuar (ata me arsimim terciar) në një shkollë ndikon pozitivisht në rezultatet e të lexuarit: për çdo rritje shtesë prej 10 përqind në pjesën e mësimdhënësve të kualifikuar

---

<sup>1</sup> Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve

.....  
të shkollës, ekziston një rritje prej 3 pikave në rezultatet e të lexuarit në PISA (OECD, 2013).

**Praktikat e mësimdhënies dhe strategjitë e të mësuarit ndikojnë pozitivisht në arritshmërinë e studentëve** – praktikat e mësimdhënies dhe strategjitë e të mësuarit kanë ndikim të madh në performancë. Shqyrtimet e politikave nxjerrin përfundime se ky faktor është i rëndësishëm në veçanti në vitet e hershme të shkollës. Zgjedhja e metodave mësimore dhe metodave të mesimnxënies të vendosura në angazhim, instruksione dhe të menduarit kritik janë të lidhura me rezultate më të larta të studentëve në krahasim me metodat e të mësuarit në kontroll dhe memorizim.

**Burimet e edukimit janë një faktor i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë së arsimit** – burimet e sistemit të arsimit sikurse kompjuterët, laboratorët dhe tekstat shkollorë janë mjete thelbësore të cilat duhet të sinkronizohen me reforma të tjera të sistemit. Disponueshmëria e teksteve shkollorë bashkëkohore dhe materialit të të mësuarit dhe raporti ndërmjet teksteve dhe studentëve janë faktorë të moderuar/ fuqishëm në arritjet e studentëve me kusht që ato të jenë sinkronizuar me qasje të përshtatshme të mësimore dhe të mesimnxënies. Qasja në TIK dhe internet po ashtu është fuqishëm e ndërlidhur me sisteme të larta të performancës por vetëm nëse ato janë të integruara me procesin mësimor. Madhësia e klasave dhe ulëseve janë parakushte të rëndësishme për mësimdhënie dhe mesimnxënie, por ato nuk kontribuojnë domosdoshmërisht në arritshmërinë e studentëve. Përkundrazi, siç është demonstruar më lartë, shkollat e vogla kanë implikime të mëdha buxhetore.

#### **Çfarë bëjnë sistemet e avancuara të arsimit për të përmirësuar performancën?**

Reformat e arsimit janë komplekse për shkak të nevojës për të përfshirë hisedarë të ndryshëm, kufizimet e burimeve dhe vështirësitë politike që mund të paraqiten posaçërisht me trajtimin e reformave të mësimdhënies. Barber (2012) i kategorizon sistemet në bazë të performancës së rezultatit të tyre në PISA dhe ka krijuar një numër intervenimesh të ndërlidhura në procesin e reformës. Sipas kësaj kornizë, ndryshimet duhet të sinkronizohen dhe zbatohen në një formë të varur në fazë. Praktikrat nga intervenimet e reformës sugjerojnë se ekziston një ndërlidhje ndërmjet fazës së performancës së sistemit dhe kufizimit të udhëzimeve qendrore ndaj shkollave – sistemet kërkojnë udhëzim të ngushtë qendror gjatë fazës 1 (dobët në të moderuar) dhe fazës 2 (moderuar në të mirë). Praktikrat ndërkombëtare gjithashtu sugjerojnë që intervenimet e propozuara jo vetëm se duhet të bazohen në vlerësime solide të gjendjes por gjithashtu duhet të **ndërtohen** në kontekstin lokal duke përfshirë kulturën dhe kundërshtimet e mundshme politike.



Tabela 1 - Çfarë bëjnë sistemet e avancuara të arsimit për të përmirësuar performancën?

FAZA	INTERVENIMET KRYESORE TË REFORMËS	PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE
I. Rrugëtimi i reformës nga i dobët në të moderuar	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>Sigurimi i cilësisë minimale</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i treguesve dhe caqeve</li> <li>Krijimi i sistemeve të të dhënave bazike</li> <li>Intervenime të udhëzuara nga qendra</li> </ul> </li> <li><b>Rritja e niveleve të shkrim-leximit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i teksteve shkollore falas</li> <li>Zgjerimi i infrastrukturës dhe ulëseve</li> <li>Rritja e regjistrimit në arsim</li> </ul> </li> <li><b>Motivimi i mësimdhënësve</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Rritja e pagës</li> <li>Sigurimi i mësimëve me shkrim</li> <li>Vizita në shkolla nga qendra</li> </ul> </li> </ol>	<p>Kili</p> <p>Gana</p> <p>India</p>
II. Rrugëtimi i reformës nga i moderuar në të mirë	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>Llogaridhënia</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies përmes vlerësimit të studentëve dhe përgjegjësisë së shkollave</li> <li>Ngritja e menaxhimit të vlerësimit të jashtëm dhe shtimi i kapaciteteve të inspektoratit të arsimit</li> </ul> </li> <li><b>Sistemet e të dhënave</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shfrytëzimi i të dhënave për të identifikuar fushat specifike për përmirësim (notimet, lëndët, aspekti gjinor) dhe përkrahja e nxënësve të prapambetur</li> </ul> </li> <li><b>Struktura organizative:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Inkurajimi i rrjeteve shkollore</li> <li>Përshkrimi i përgjegjësisë</li> <li>Krijimi dhe zbatimi i mekanizmave efikas dhe të barabartë të financimit për shkolla (decentralizimi)</li> <li>Optimizimi i mësimdhënësve dhe shkollave</li> </ul> </li> <li><b>Modeli i të mësuarit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ngritja e performancës së studentëve</li> <li>Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve në kurikulla dhe tekste shkollore</li> <li>Zbatimit i kornizës të bazuar në kompetenca</li> </ul> </li> </ol>	<p>Sloveni 1995-2004</p> <p>Letoni 1991-2004</p> <p>Lituan 1991-2004</p>
III. Rrugëtimi i reformës nga i mirë në të shkëlqyer	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>Rekrutimi i mësimdhënësve</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ngritja provimit pranues për mësimdhënës</li> <li>Zgjedhja e nxënësve më të mirë të shkollave të mesme për mësimdhënies të programeve arsimore</li> <li>Zbatimi ekzaminimit para-shërbimit për mësimdhënës</li> </ul> </li> <li><b>Trajnimi para-shërbimit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ofrimi i skemave të mentorimit</li> <li>Këshillimi gjatë trajnimit së para-shërbimit dhe në punë</li> <li>Ofrimi i 80-150 mundësi vjetore të zhvillimit profesional</li> </ul> </li> <li><b>Vetë-vlerësimi</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shkollat zbatojnë vetë-vlerësimin</li> <li>Shkollat krijojnë caqe dhe profile vetanake pavarësisht vlerësimeve të jashtme</li> </ul> </li> <li><b>Fleksibiliteti i shkollave</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shkollat marrin pjesë aktivisht në zhvillimin e kurikullave</li> </ul> </li> </ol>	<p>Letoni 2001 +</p> <p>Lituan 2001+</p> <p>Sloveni 2006 +</p> <p>Singapor</p> <p>Kore Jugore</p>

Në mesin e ekspertëve të arsimit ekziston një konsensus se duhet gjashtë veprime thelbësore pavarësisht se në cilën fazë janë sistemet themelore të arsimit dhe ato përfshijnë: rishikimi i kurikullave dhe standardeve; strukturë të përshtatshme të shpërblimit për mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave; vlerësim të jashtëm të nxënësve; krijimi i sistemeve të të dhënave dhe ngritja e kapaciteteve për zhvillimin e politikave duke përfshirë ligjet dhe rregulloret.

---

## Struktura dhe performanca e Arsimit Para-Universitar të Kosovës

### Struktura e arsimit të Kosovës

Sistemi arsimor i Kosovës përfshinë një numër hisedarësh kryesor të përbërë nga institucionet qendrore (Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Komunitat dhe shkollat. Qeveria përcakton kornizën e gjerë ligjore dhe ndan buxhetin për arsimin duke reflektuar prioritetet e saj. MASHT zhvillon politikën në të gjitha aspektet substanciale të arsimit duke përfshirë kurikulën, standardet e mësimdhënies, kualifikimet profesionale, dhe sistemet e ekzaminimit. Ministria përcakton standardet themelore për komunitat, harton politikën e ardhshme dhe siguron kornizën ligjore për qeverisjen, administrimin dhe arsimin në të gjitha nivelet e sistemit. Ministria po ashtu kërkon buxhetin e gjithmbarshëm për arsimin dhe së bashku me Ministrinë e Financave vendos për ndarjet buxhetore për komunitat sipas kritereve të parapërcaktuara. MASHT ofron përkrahje profesionale (udhëzime, përkrahje për zhvillimin e burimeve njerëzore) dhe përkrahje infrastrukturore për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) për arritjen e synimeve kombëtare të arsimit.

Përderisa MASHT ofron mbështetje dhe organin përgjegjës për planifikimin dhe monitorimin e sistemit arsimor, Komunitat janë përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e arsimit para-universitar duke përfshirë zbatimin e kurikulave, rekrutimin e personelit, zhvillimin e pronave, mirëmbajtjen dhe shërbimet komunale. Qeverisja lokale është përgjegjëse për të ofruar mbështetje Këshillave të Shkollave në zhvillimin e politikave shkollore rreth zbatimit të kurikulave, personelit, financimit dhe menaxhimit të aseteve. Drejtorët e shkollave udhëheqin anën profesionale, planifikojnë dhe menaxhojnë funksionimin e shkollave. Ata janë të mandatuar të mbikëqyrin zbatimin e kurikulës në shkollë dhe të monitorojnë afër performancën e mësimdhënësve dhe nxënësve, të planifikojnë dhe menaxhojnë buxhetin e shkollave dhe të sigurojnë mirëmbajtjen e infrastrukturës. Procesi i alokimit të buxhetit për arsimin komunal dhe shkollat përgatitet në nivelin qendror (Ministria e Financave) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Pjesa që dedikohet për arsimin komunal llogaritet duke shfrytëzuar një formulë të bazuar në numrin e nxënësve të regjistruar në një komunë. Aspekti më i rëndësishëm në procesin e llogaritjes është numri i nxënësve por shuma të tjera shtohen për të mbuluar kostot tjera të funksionimit të shkollave: shkolla të vogla në vende të largëta rurale, fëmijët me nevojë të veçanta dhe komunitetet pakicë.

Sistemi i arsimit para-universitar në Kosovë funksionon përmes një rrjeti prej 42 institucioneve para-shkollore, 989 shkolla fillore dhe shkolla të mesme të ulëta, dhe 116 shkolla të mesme të larta (MASHT, 2014). Përveç kësaj, ekzistojnë 10 institucione private të licencuara të cilat ofrojnë arsim fillor dhe të mesëm, si dhe një numër i institucioneve private që ofrojnë shërbime të arsimit para-shkollor. Duke qenë se procesi i licencimit për institucione private të cilat ofrojnë shërbime të arsimit para-universitar është akoma në progres, numri i saktë i tyre nuk është i njohur. Megjithatë, Agjencia e Statistikave të Kosovës (2014) raporton për rreth 19 institucione të arsimit parashkollor në pesë komuna.

Sistemi i arsimit para-universitar në Kosovë përbëhet nga katër nivel: Arsimi Para-shkollor (ISCED 0)<sup>2</sup> i cili nuk është obligativ dhe korrespondon për fëmijët e grup moshave 0-5 vjeçare; Arsimi Fillor (ISCED1) që është obligativ dhe korrespondon për nxënësit e grup moshave 6-10 vjeçare; Arsimi i Mesëm i Ulët (ISCED2) që është obligativ dhe korrespondon për fëmijët 11-14 vjeçare; dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (ISCED 3) që është jo-obligativ dhe korrespondon për fëmijët 15-17

---

<sup>2</sup> Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit

(18) vjeçar. Ky nën sektor i arsimit rregullohet përmes ligjit për arsimin para-universitar (2011) dhe një numër udhëzimesh administrative.

Tabela 2 – Struktura e arsimit në Kosovë

ISCED	Niveli	Klasat	Grup mosha
ISCED 0	Parashkollor		(3-5)
ISCED 1	Para-fillor	G 0	5
ISCED 1	Arsimi fillor	G 1-5	(6-10)
ISCED 2	I mesëm i ulët	G 6-9	(11-14)
ISCED 3	I mesëm i lartë	G 10-12	(15-17)
ISCED 4	Arsimi i Lartë		18

## Performanca e Arsimit para-universitar të Kosovës

### Përmbledhje e problemit

**Rritja e financimit dhe investimeve nuk kanë prodhuar rezultatet e pritura në arritshmërinë e nxënësve** – një analizë e përqindjes së përmirësimit të inputeve kryesore të arsimit dhe arritshmërisë së nxënësve në maturën kombëtare tregon se përderisa është bërë një përmirësim i dukshëm i financimit, pagave, raportit nxënës-mësues dhe nxënës-klasa gjatë viteve të fundit, kjo ka dështuar të prodhojë ndikimin e dëshiruar në raportin e arritshmërisë së nxënësve në ekzaminimet dalëse. Kur shikohet më afër, shpenzimet në ndërtimin e shkollave të reja dhe rritja e shpenzimeve për paga, edhe pse parakusht i rëndësishëm në të gjitha sistemet e arsimit, ato nuk duket të kenë ndonjë ndikim në arritshmërinë e nxënësve.




Figura 1 - Përqindja e përmirësimit të inputeve të arsimit dhe arritshmëria e nxënësve

**Kosova pritet të ketë rezultatin më të ulët të performancës në PISA në Evropë** – Kosova ka marr pjesë në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve të OECD-së, PISA 2015. Rezultatet përfundimtare do të publikohen në vitin 2016. Megjithatë, bazuar në modelet e projeksionuara dhe nivelin e zhvillimit socio-ekonomik, rezultati i përgjithshëm i Kosovës në PISA ka gjasa të bie në zonën e 370-400 pikë. Kjo do ta vendoste rezultatin e Kosovës si më të ulët ndër vendet e Evropës dhe të Azisë Qendrore në matematikë, shkencë dhe shkathtësi të të lexuarit. Nën një skenar të tillë, Kosova mbetet rreth 60 pikë të PISA prapa Malit të Zi, 100 pikë prapa Sllovenisë dhe 120 pikë prapa vendeve të OECD-së. Secili hendek prej 40 pikësh është i barabartë me përafërsisht një vit të shkollimit. Në thelb, mesatarja e nxënësve të Kosovës mbeten pas rreth një vit prapa Malit të zi, 2 vite

.....

prapa Sllovenisë dhe rreth tri vite të shkollimit prapa nxënësve të vendeve të OECD-së. Në përgjithësi duhet të mbahet ky supozim duke marr parasysh rrethanat e zhvillimit të arsimit në Kosovës dhe nivelin e progresit socio-ekonomik.




Figura 2 – PISA 2012 - parashikim

**Performanca e dobët e studentëve në vlerësimet kombëtare të jashtme** – i organizuar nga MASHT për studentët e nivelit përfundimtar të arsimit obligativ (Testi i arritshmërisë) dhe arsimit të mesëm të lartë (Testi i Maturës) është kritikuar gjerësisht për shkak të administrimit të dobët dhe mungesës një sistemi për adresimin e mangësive ose sjelljen e efekteve të dëshirueshme. Figura 3 ofron një pasqyrë të përqindjes së kalueshmërisë përgjatë viteve që demonstroi nivele të ndryshme të mospërputhshmërisë, kryesisht të atribuuar tek administrimi i dobët.




Figura 3 - Shkalla e kalimit të provimit të maturës sipas viteve 2008-2014  
Burimi: Arkiva e Lajmeve MASHT - <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=82>

Krahas kësaj, niveli mesatar i kalueshmërisë në Provimin e Maturës ishte 55.1% në vitin 2010, dhe 51.3% në vitin 2011 (MASHT, 2013). Vërejtjet të njëjta sa i përket administrimit mund të bëhen edhe për testin e arritshmërisë që i nënshtrohen të gjithë nxënësit në fund të arsimit të detyrueshëm. Përqindjet e arritjes në vitin 2010 dhe 2011 ishin 57.31% dhe 54.96% (MASHT, 2013).

Një test më i besueshëm, i klasës së pestë i bazuar në mostër i ndërmarr në vitin 2008 tregon nivelin e arritjes në gjuhën amtare prej 43.2% dhe në matematikë në vetëm 26.4%, në total 34.8%. Kjo duket një përmirësim i konsiderueshëm që nga viti 2008, por akoma studentët që hyjnë në klasën e gjashtë veç kanë humbur 2/3 e matematikës që ata duhet ti mësojnë në fund të shkollës fillore. Në mënyrë të qartë, kjo rrezikon suksesin të tërë sistemit arsimor, i bazuar në themelet e arsimit fillor. Në anën tjetër,

arritjet relativisht të ulëta të studentëve në Testin e Arritshmërisë dhe Provimin e Maturës, përkundër të metave serioze në sistemin e vlerësimit, tregon nevojën për përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Edhe pse standardet ndërkombëtare nuk do të jenë të mundshme deri në vitin 2015, kur Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA) do të i disponueshëm, rezultatet e përgjithshme të testit të klasës së pestë shfaqin kontraste të shumta komunale, si dhe hendeqe ndërmjet djemve dhe vajzave, nxënësve nga hapësirat rurale dhe urbane, që kërkon veprime për të lehtësuar dhe zvogëluar këto dallime (Grupi i Bankës Botërore, 2014).

### Problem statement

Arsimi i detyrueshëm në Kosovës përbëhet nga 5 vite të arsimit fillor (ISCED 1), dhe 4 vite të arsimit të mesëm të ulët (ISCED 2). Kjo bazohet në Kornizën e Kurikullave dhe kurikullën themelore. Sipas të dhënave statistikore, 383, 609 nxënës kanë vijuar shkollimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Kosovë gjatë vitit shkollor 2013/14. Personeli kishte përbërje prej 22,809 mësimitdhënësve, 1,219 personel administrativ dhe 2,351 personel ndihmës (MASHT, 2014).

Tabela 3 – Statistikat kyçe të arsimit të obliguar në Kosovë

	2010	2011	2012	2013	2014
<b>Numri i nxënësve në arsimin para-universitar (ISCED1,2,3)</b>	415,797	408,410	402,646	392,646	383,609
<b>Numri i mësimitdhënësve</b>	22968	22685	22905	22764	22809
<b>Raporti nxënës-me-mësimitdhënës</b>	18.1	17.8	17.5	17.2	16.7

**Kosova ka arritur pothuajse regjistrimin bruto universal në të gjitha nivelet e arsimit të detyrueshëm** – përqindja e vijimit bruto në arsimin para-universitar (fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë) në Kosovës është ngritur gjatë viteve të fundit, megjithëse është pak nën nivelin universal. Progres domethënës është arritur në rritjen e niveleve të vijueshmërisë/regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë nga 82 përqind në 87 përqind në vitin 2014. Në përgjithësi, Kosova ka arritur progres në ofrimin e arsimit të detyrueshëm për pothuajse të gjithë fëmijët. Megjithatë, mbetet ende prapa në nivelin e arsimit para-fillor dhe para-shkollor. Vijueshmëria e fëmijëve nga 3-5 vjeçar është akoma e ulët (26.7 përqind) dhe mund të ndikoj negativisht në perspektivën e mëvonshme të mësimit-nxënies së tyre.




Figura 4 - Vijueshmëria e përgjithshme në të gjitha nivelet e arsimit 2008-2014

**Normat e ulëta të vijueshmërisë në arsimin para-shkollor mund të ndikoj në arritshmërinë e nxënësve dhe cilësinë e përgjithshme të arsimit** – Nëse analizohet ky graf më afër, norma e regjistrimit në një vit të arsimit para-fillor (fëmijët e moshës 5 vjeçare) është mjaft i kënaqshëm (76 përqind) për është shumë i

.....

ulët për grup moshat 3 deri 4 vjeçare. Arsimi parashkollor nuk ka qenë akoma një politikë prioritare dhe janë bërë investime të pakta ose fare në aspektin e burimeve njerëzore dhe të infrastrukturës gjatë katër viteve të fundit. Studime të shumta kanë dëshmuar përparësitë e arsimit parashkollor dhe parafillor si shumë relevant për të arritur sukses në arsimin formal. Arsimi parashkollor dhe parafillor janë qenësore për të mbështetur fëmijët të fitojnë shkathtësi të rëndësishme para arsimimit, sikurse vetëdijësimin fonologjik dhe shkathtësitë e të shkruarit/narrative, si dhe të fitojnë prirje të të pëlqimit të librave, njohurit për shkronjat dhe shkathtësi bazike të të lexuarit dhe shkruarit. Kjo në veçanti aplikohet për fëmijët që jetojnë në mjedise të shoqërore të pafavorshme, të cilët tradicionalisht vijojnë në nivelin më të ulët në sistemin formal të arsimit. Nga kjo perspektive një pjesëmarrje e tillë në këtë nivel të arsimimit pashmangmërisht ndikon në performancën e fëmijëve në vitet e hershme të arsimit të detyrueshëm dhe vendos shumicën prej tyre në një ritëm më të ngadalësuar të zhvillimit personal

**Krahasimet rajonale tregojnë se Kosova rangohet ndër vendet me regjistrim/vijueshmëri të lartë në arsim –** Tabela 4 tregon se, në aspektin e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm të lartë, Kosova qëndron më mirë se Maqedonia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia, por prapë mbetet prapa vendeve të tjera të rajonit (MASHT, 2014).

Tabela 4 - Regjistrimi bruto në arsim (GER) – Krahasimi rajonal 2014

	Para-shkollor	Fillor	I mesëm i ultë	I mesëm i lartë
<b>Kosovë</b>	26.7	96.4	98	97
<b>Shqipëri</b>	70.6	99.5	92.5	85
<b>Serbi</b>	53.2	92.96	98	85.7
<b>Mali i Zi</b>	60.9	100.9	96	97.6
<b>Maqedoni</b>	25.5	89	90.2	77.4
<b>Kroaci</b>	61.3	96.98	104.7	87
<b>Sllloveni</b>	89.7	98.93	95.3	98.6
<b>Bosnje dhe Herceg.</b>	17.4	90	92.1	86.4
<b>Bullgari</b>	79.4	99.5	83.1	93.6

**Financimi për sektorin e arsimit është rritur në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2011 por shpenzimet për student janë shumë të ulëta** - shpenzimet publike në arsim të shprehura në përqindje të shpenzimeve vjetore të qeverisë dhe të krahasuara me BPV janë të krahasueshme me praktikat rajonale dhe të BE-së. Shpenzimet nominale janë rritur dukshëm krahasuar me vitin 2011. Megjithatë, shpenzimet për nxënës janë të ulëta në krahasim me mesataret rajonale, të BE-së dhe OECD-së. Kjo qëndron pjesërisht për shkak të bazës së ulët të BPV-së dhe buxhetit qeveritar dhe pjesërisht për shkak se Kosova ka shumë më tepër nxënës për totalin e popullatës se sa vendet tjera. Në anën tjetër, të dhënat e shpenzimeve të vitit 2014 tregojnë se rreth 85 përqind të grantit komunal për arsim ka shkuar për paga dhe mëditje.

Tabela 5 - Shpenzimet (në milion Euro) në arsim e shprehur në indikator standard dhe nën-sektorial 2011-2014

	2011	2012	2013	2014
<b>BPV</b>	4,773	4,916	5,327	5,581
<b>Shpenzimet në sektorin e arsimit</b>	218.9	230.4	230.5	262.3
<b>% BPV në arsim</b>	4.60%	4.70%	4.30%	4.70%
<b>Totali i buxhetit qeveritar</b>	1,415	1,441	1,469	1,589
<b>Buxheti për Arsim (%)</b>	15.50%	16.00%	15.70%	16.50%
<b>Shpenzimet për arsimin para-universitar</b>	183.95	192.57	188.80	210.99
<b>Shpenzimet për student (Euro)</b>	385	405	419	484

**Burimi:** Ministria e Financave/MASHT  
 Shënim (1): Fondet lokale përfshijnë jo vetëm grantin specifik për arsim por gjithashtu vet-financimin nga komunat/granti i përgjithshëm i komunave. Shpenzimet në arsimin para-universitar përfshijnë financat lokale dhe shpenzimet nga MASHT të dedikuara për nivelin e arsimit para-universitar. Shpenzimet në arsimin e lartë përfshijnë shpenzime për institucionet publike të arsimit, shpenzimet e MASHT për arsimin e lartë, UP, KASA, KAPS, BK.

**Numri i studentëve është ulur në mënyrë të konsiderueshme për shkak të ndryshimeve demografike** – sektori i arsimit është duke përjetuar ndikimin e ndryshimeve demografike. Numri i nxënësve në arsimin para-universitar në vitin 2014 është për 32,188 më i ulët se sa në vitin 2011. Kjo ulje prej 9 përqind të numrit të studentëve ka qenë në veçanti e lartë në arsimin fillor dhe në një masë më të vogël në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë. Ky trend negativ llogaritet të vazhdoj deri në vitin 2020. Bazuar në projeksionet e popullatës (ASK, 2014) deri në fillim të dekadës së ardhshme Kosova do të ketë 331,653 student në arsimin para-universitar dhe kjo nënkupton rreth 84,000 më pak student se sa në vitet 2010/2011.




Figura 5 – Numri i studentëve para-universitar dhe trendet e financimit

Këto zhvillime janë si rrjedhojë e ndikimit të normës së ulët të lindjeve por gjithashtu edhe të heqjes së një niveli nga arsimi i mesëm i lartë (Klasa 13) si pjesë e reformave strukturore. Kosova ka një numër të madh të studentëve para-universitar në sajë të strukturës së re demografike. Ky trend do të heq një

.....

pjesë të ngarkesës nga sistemi dhe do të liroj financimin për investime të mundshme në cilësi. Si vërehet në grafën më poshtë, kjo do të zgjoj dhe krijoj një momentum për rishqyrtimin e numrit të mësimdhënësve dhe madhësisë së klasave. Disa implikime të mundshme të politikave janë se Kosova mund të ketë nevojë të inicioj një politik të optimizimit të mësimdhënësve dhe të rialokoj disa prej burimeve drejt përmirësimit të nivelit të regjistrimit/vijueshmërisë në arsimin para-shkollor.

## **Përmbajtja dhe Burimet e Arsimit**

### **Korniza e Kurikulës dhe Standardet**

Korniza e rishikuar e Kurikulës promovon një qasje të bazuar në kompetencë, e zhvilluar përmes të mësuar e orientuar nga praktika. Kalimi nga kurikulla e bazuar në përmbajtje në atë të bazuar në kompetencë është menduar të shtoj arritjet e fëmijëve dhe orientimin në tregun e punës dhe shoqëri. Kurikulla e reformuar është e strukturuar rreth shtat fushave të të mësuarit që aplikohen nga arsimit para-shkollor deri në arsimin e mesëm të lartë, duke përfshirë si arsimin e përgjithshëm ashtu edhe atë profesional: 1) Gjuhët dhe Komunikimi; 2) Arti; 3) Matematika; 4) Shkenca; 5) Shoqëria dhe mjedisi; 6) Shëndetësia dhe mirëqenia; 7) Jeta dhe puna. Kompetencat kryesore përfshijnë: 1) Komunikimin dhe të shprehurit; 2) Të menduarit; 3) Mësimnxënia; 4) Jeta, puna dhe mjedisi; 5) Kompetenca personale; 6) Qytetare.

KKK mundëson decentralizimin, vendimmarrje të bazuar në shkolla (përafërsisht 10-20% e kohës shkollore). Bazuar në parimet dhe normat e autonomisë së shkollave, shkollat do të kenë mundësi të vendosin se si të shfrytëzojnë më së miri këtë kohë për të kontribuar në zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe sjelljeve të nxënësve në lidhje me burimet, nevojat dhe perspektivën e zhvillimit vendor. Shkollat mund të zhvillojnë elemente shtesë të kurikulës për të përmbushur nevojat individuale të nxënësve dhe për të reflektuar rrethanat e komunitetit ku funksionon shkolla. Ndër të tjera, korniza synon fuqizoj pjesëmarrjen dhe rolin e studentëve, mësimdhënësve, shkollave dhe hisedarëve. Qasja e bazuar në kompetenca ka implikime të rëndësishme në zhvillimin e kurikulës, si dhe për praktikën e klasave (për shembull, integrimi i çështjeve horizontale, sikurse shkathtësitë jetësore; të mësuarit e integruar; mësimdhënia dhe të mësuarit në mënyrë interaktive; fokus në vlerësimin formues dhe të progresit). Zbatimi i qasjes së re të kurikulës kërkon më tepër burime dhe materiale mësimore, trajnime të mësimdhënësve dhe metoda, strategji të reja të vlerësimit dhe kontribut aktiv nga të gjithë akterët e përfshirë.

Kurikulla e re është pilotuar për një vit në 10 shkolla, dhe shtrirja e pilotimit në më tepër se 100 shkolla fillore dhe të mesme është në progres. Megjithatë, procesi i zbatimit është prapa kalendarit të planifikuar. Plani fillestar i zbatimit ka vënë vitin 2014 për zbatim në mbarë Kosovën. Deri në vitin 2015 vetëm 10% e shkollave janë duke e zbatuar ose duke e pilotuar atë. Procesi i zbatimit është përballur me një numër sfidash: vështirësitë për të transformuar modelet e mësimdhënies dhe të mësuarit nga mësimdhënësit tek nxënësit, vështirësi për të zbatuar vlerësimin e nxënësve bazuar në rezultatet e të mësuarit dhe disponueshmërinë e burimeve të nevojshme dhe materialet për mësimdhënie. Një përqaqindje e konsiderueshme e mësimdhënësve (shiko kapitullin në vijim) nuk kanë kualifikime të duhura, njohuri përmbajtësor dhe aftësi pedagogjike për tu përshtatur plotësisht me kërkesat e kurikulës së re. Për më tepër, për shumë mësimdhënës ka qenë disiplina në vend të angazhimit të nxënësit mësimdhënie e zakonshme. Studentët gjithashtu janë familjarizuar me memorizim dhe përsëritje të mësimin dhe si rrjedhojë pjesëmarrja aktive dhe praktikën e të menduarit kritik mund të marrin kohë për tu përshtatur/pranuar.

### **Teknologjia informative dhe e komunikimit**

**Mos përparimi në teknologjinë informative dhe të komunikimit** – Zbatimi i strategjisë për inkorporimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit në mësimdhënie nuk ka përparuar siç është pritur. Krijta e cilësisë në të gjitha nivelet varet në aftësinë e mësimdhënësve dhe nxënësve në përshtatjen e lehtësirave dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Pajisja e shkollave me kompjuter dhe



.....

lidhje interneti ka përparuar por ende mbetet prapa. Norma kompjuter-student në shkollat e Kosovës është 1:46 dhe në mënyrë të konsiderueshme më e ulët se sa mesatarja e BE-së ku një kompjuter shërben për 3-7 nxënës (EC, 2013). Lidhja e internetit është e mundshme në 523 shkolla të Kosovës prej totalit të 1154 shkollave dhe rreth 57% të mësimitdhënësve kanë marr pjesën në trajnimin për licencim të punës me kompjuter (European Computer Driving License).

Zhvillimi TIK si në aspektin e numrit të kompjuterëve ashtu edhe në aspektin e lidhjes me internet është nën mesataren kombëtare. Kjo tregon se shkollat nuk udhëheqin me praktika inovative në komunitetet e tyre por ndjekin zhvillimet në shoqëri. Në shumë shkolla të cilat janë të pajisura me kompjuter dhe lidhje interneti, qasja është e kontrolluar dhe shfrytëzohet vetëm për qëllime të menaxhmentit. Vlerësimet ndërkombëtare tregojnë se pajisja e shkollave me kompjuter nuk ndikon në përmirësimin e cilësisë së arsimit nëse teknologjia nuk është plotësisht e integruar në procesin mësimor. Kosova ballafaqohet me çështje serioze në këtë aspekt duke qenë se ofrimi i mësimin në harmoni me teknologjinë bashkëkohore nuk është e mundur derisa mësimitdhënësit nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë TIK-un. Përderisa korniza e re e kurikulës kërkon që të sigurohet se minimalisht një lëndë të jepet përmes TIK-ut, është e pamundur të ofrohet mësim i bazuar në teknologji në mungesë të kompjuterëve dhe lidhjes me internet. Bazuar në statistikat dhe raportet e disponueshme, mund të përfundohet se TIK nuk është pjesë përbërëse e procesit mësimor.

Në sistemin arsimor Evropian janë ndërmarr shumë nisma për integrimin e shfrytëzimit të TIK-ut në arsim. Këto nisma ishin përqendruar në promovimin e digjitalizimit të të mësuarit dhe qasjes në burime të hapura arsimore. Në vitin, 2008 Estonia lansoi nismën Laptop për Student/Laptop për Mësimitdhënës përmes së cilës 4000 mësimitdhënës dhe 16000 student janë pajisur me laptop. Nga mësimitdhënësit është kërkuar të demonstrojnë vullnet për shfrytëzimin e TIK-ut në zbatimin e kurikulës dhe është kërkuar të jenë kampion në promovimin e digjitalizimit. Në vitin 2007, Franca lansoi Plan Ordinateur Portable për t'i mundësuar 50,000 studentëve nga shkollat profesionale teknike të pajisen me laptop të subvencionuar nga qeveria. Një iniciativë paralele 'Un collegian un ordinateur portable' ishte zbatuar në një shkollë më të gjerë dhe ka përfshirë shpërndarjen e 10,000 laptopëve, 970 video projektorëve, 760 tabela interaktive, 145 skener, 150 shtypës, dhe 160 kamera për çdo vit në shkolla. Gjeorgjia lansoi iniciativën pilot 'Buki' për të ofruar 3000 iPad për fëmijët e nivelit para-shkollor dhe para-fillor për të promovuar lojërat edukative dhe shfrytëzimin e teknologjisë nga fëmijët. Greqia ka zbatuar një projekt të madh të TIK-ut për të pajisur 120,000 nxënës të shkollës së mesme të lartë dhe mësimitdhënësit me laptop. Projekti është financuar nga BE duke siguruar kupon me vlerë prej 450 euro për secilin nxënës për blerjen e laptopëve. Ky projekt më vlerë 55 milion Euro gjithashtu ka përfshirë trajnimin dhe certifikimin e 111,000 mësimitdhënësve. Turqia në vitin 2011 ka filluar zbatimin e projektit ambicioz 'Fatih Project' me qëllim të përmirësimit të shfrytëzimit të teknologjisë në procesin e të mësuarit duke ofruar Notebook dhe tabela të mençura LCD për të gjitha shkollat.

## **Mësimitdhënësit në Kosovë**

### **Kuadri i mësimitdhënësve sipas gjinisë dhe moshës**

Të dhënat nga MASHT dhe të dhëna tjera qeveritare shfaqin një tendencë të plakjes së mësimitdhënësve në Kosovë. Rreth 41 përqind e mësimitdhënësve janë më të vjetër se 50 vjeçar. Kosova është ndër vendet e pakta me fuqinë punëtore më të vjetër të mësimitdhënësve, në krahasim me vendet e BE-së dhe Evropës Qendrore dhe Lindore. Mësimitdhënësit përfshijnë numër të lartë me më tepër se 50 vjeçar dhe kjo mund pengoj reformat strukturore në zbatimin e kornizës së re të kurikulës dhe mund të shndërroj investimet në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve si të padobishme. Në anën tjetër përqindja e mësimitdhënësve nën 30 vjeçar është më e lartë në krahasim me vendet e BE-së. Rritja e numrit të mësimitdhënësve nën 30 vjeçar nuk mund të konsiderohet një faktor krejtësisht pozitiv në bazë të pikëpamjeve të ekspertëve rreth nivelit arsimimit dhe njohurive të tyre në lëndët përkatëse. Rreth

gjysma e mësimitdhënësve përfshinë mësimitdhënës me kualifikime të fituara pas vitit 1990 kur Kosova kishte programe të kualifikimit pedagogjik me cilësi të ulët.

Tabela 6 – Kosovë: Grup moshat e mësimitdhënësve 2014

	< 30	30-39	40-49	50-59	>= 60 vjeçar
Nr.	3379	6148.0	5242.0	6718.0	3262.0
%	13.65	24.84	21.18	27.14	13.18

Burimi: MASHT/Ministria e Administratës Publike 2014 dhe EUROSTAT 2012




Figura 6 – Grupmoshat e mësimitdhënësve – krahasim

Bilanci gjinor e fuqisë punëtore të mësimitdhënësve ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Numri i femrave në këtë fuqi punëtore është rritur me gati 2000 krahasuar me vitin 2008 (MASHT, 2014). Megjithatë, një analizë me e hollësishme pasqyron se kuadri i mësimitdhënësve në nivelin para-shkollor është i përbërë me pothuajse 100 përqind femra. Ndonëse, përqindja e femrave mësimitdhënësë bie dukshëm në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (52 përqind) dhe arsimin e mesëm të lartë (39 përqind).

Tabela 7 - Kuadri i mësimitdhënësve sipas gjinisë

	Totali	Para-shkollor	Fillor/i mesëm i ulët	I mesëm i lartë
Meshkuj	49.8%	0.4%	53.4%	61.2%
Femra	50.2%	99.6%	46.6%	38.8%

### Kualifikimet e mësimitdhënësve

Kualifikimi mbizotërues për mësimitdhënësit e shkollave në Evropë janë studimet themelore (bachelor) përveç për mësimitdhënësit në arsimin e mesëm të lartë të cilët në shumicën e vendeve duhet të kenë studime Master (EC, 2013). Këto programe zakonisht zgjasin ndërmjet katër dhe pesë vite. Vetëm në Republikën Çeke, Gjermani, Austri, Maltë dhe Sllovakia mësimitdhënësit e arsimit parafillor (personeli i kualifikuar për atë nivel) nuk kryejnë arsimin e lartë por në vend të kësaj kanë kualifikim në nivelin e mesëm të lartë ose post-shkollim të mesëm. Mënyrat alternative për të fituar një kualifikim për mësimitdhënë, sikurse programe të shkurtra punësimi për ndryshime të karrierës nuk janë aq të përhapura në vendet Evropian.

Në shumicën e vendeve kualifikimi minimal për mësimitdhënë në nivelin parafillor është shkalla

.....

edukimit terciar në nivel bachelor, që zgjatë tre deri katër vite. Megjithatë në Republikën Çeke, Maltë, Austri dhe Sllovaki kualifikimet më të zakonshme për arsimin parafillor janë të nivelit të mesëm të lartë ose niveli i shkollimit jo-terciar, post-shkollimi i mesëm. Gjithashtu, për mësimdhënësit e arsimit fillor kualifikimi i nivelit bachelor është kualifikimi minimal më i zakonshëm. Në shumë vende, programet e shkollimit për mësimdhënëse të rinj kërkojnë integrimin e trajnimit profesional në të gjitha pjesët e programit në mënyrë që të vendoset një qasje holistike e integruar që qon në një shkallë profesionale.

Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (2014) për numrin e mësimdhënësve, kualifikimet e tyre dhe strukturën gjinore sipas niveleve ISCED janë të përmbledhura në grafën e mëposhtëm, që tregon se kualifikimet e mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët nuk kanë një nivel bachelor të kualifikimit. Rreth 62 përqind e mësimdhënësve në arsimin fillor janë dukshëm nën praktikat Evropiane. Situata është e ngjashme në arsimin e mesëm të ulët ku 54 përqind e mësimdhënësve janë të nën-kualifikuar.




Figura 7 – Kualifikimet e mësimdhënësve  
Burim: ASK 2014

MASHT në vitin 2014 ka miratuar një Udhëzim Administrativ (UA 09/2014) që rregullon normativën për personelin arsimor në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar. Objektiva kryesore e kësaj rregullore ishte rregullimi i kritereve të kualifikimit të personelit arsimor në arsimin parashkollor, parafillor, dhe para-universitar. Ky instrument ligjor përcakton se të gjithë mësimdhënësit nën moshën 51 vjeçare të cilët janë të angazhuar në aktivitete të mësimdhënies dhe të cilët nuk kanë kualifikimet e duhura për lëndët të cilat i japin duhet të angazhohen në programe të obligueshme arsimore për avancimin e kualifikimeve të tyre.

Në vitin 2011, Ministri e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka krijuar një grup punues për të propozuar një strukturë të re për programet arsimore të mësimdhënësve të bazuar në rekomandimet nga vlerësimi i programeve të Fakultetit të Edukimit (Asunta et al, 2010). Ministri në vitin 2012 vendosi që të gjitha institucionet e arsimit të lartë duhet të rishikojnë programet e arsimore të mësimdhënësve në përputhshmëri me dispozitat e Kornizës së Kurikulës së Kosovës të miratuar në vitin 2011, si dhe rekomandimet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (MASHT, 2012). Pikat kryesore në bazë të të cilës duhej të zhvillohet ristrukturimi ishin:

- Programet e edukimit të mësimdhënësve të bazuar në lëndë do të rezultojnë me titull Master (300 ECTS, me 180 ECTS në trajnim akademik dhe 120 ECTS në pedagogji dhe mësimdhënie praktike.
- Programet e edukimit të mësimdhënësve duhet të përfshijnë: a) Trajnime akademike të ofruara nga njësitë akademike; b) trajnim pedagogjik dhe mësimdhënie praktike, të ofruara nga Fakulteti i Edukimit për të gjitha nivelet dhe profilet e arsimit.

.....

Vendimi nuk kishte ndikim në programet për përgatitjen e mësimitdhënësve për nivelet e arsimit parashkollor dhe parafillor të cilat pritet të ofrohen nga Fakulteti i Edukimit dhe të rezultojë në titull Bachelor (240 ECTS). Sipas këtij vendimi, Fakulteti i Edukimit ka zhvilluar ciklin e parë të pesë programeve të nivelit master për të rezultuar në titull të mësimitdhënies lëndore, dhe është në proces të zhvillimit më tepër programe të tilla për të përmbushur nevojat e sistemit të arsimit para-shkollor.

### **Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve**

Në shumicën e sistemeve Evropiane të Arsimit, planet për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional përgatiten në nivelin e shkollave dhe ato shpesh janë të detyrueshme. Megjithatë në shumë vende ose rajone, autoritetet e nivelit të lartë vendosin tema ose fusha prioritare. Për më tepër, në shumë vende ato po ashtu përcaktojnë se çfarë trajnime shtesë duhet t'i nënshtrohen mësimitdhënësit në mënyrë që të kualifikohen për pozitë të re, për shembull nëse ata dëshirojnë të japin një lëndë të re në nivel më të lartë. Në Greqi dhe Kroaci, planifikimi i Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional është realizuar drejtpërdrejt nga autoritetet e nivelit të lartë të arsimit. Disa prej sistemeve arsimit kërkojnë që mësimitdhënësit të kenë planet individuale të Zhvillimit profesional. Zakonisht këto plane individuale zhvillohen në nivel të shkollave gjatë procedurës së vlerësimit të mësimitdhënësve, por në disa vende është proces i veçantë. ZHVP i aranzhuar nga institucionet e arsimit të lartë, në formë të kurseve të shkurtra ose programe të plota graduese, zakonisht i nënshtrohen monitorimit dhe/ose akreditimit nga organe të jashtme të sigurimit të cilësisë për arsimin e shkallës së tretë.

Edhe pse planifikimi i ZHVP-së kryesisht realizohet nga menaxhmenti i shkollës, zakonisht zbatohet në bashkëpunim me palë të tjera (p.sh. ofruer të shërbimeve) dhe të gjitha nivelet përkatëse të vendimmarrjes. Inspektorët shpesh bëjnë rekomandime për menaxhmentin e shkollës mbi fushat që mësimitdhënësit duhet të adresojnë për të përmirësuar njohurit dhe shkathtësitë e tyre. Nga shtatë sisteme të arsimit është vërejtur që konsiderohen lloje të caktuar të ZHVP, ose një numër minimal i orëve të ZHVP-së, si të nevojshme për të mbajtur një grade të caktuar profesionale. Për shembull, Hungaria kërkon që të gjithë mësimitdhënësit të vijnë 120 orë të ZHVP për çdo të shtatin vit në mënyrë që të qëndrojnë në profesion. Rumania kërkon që secili mësimitdhënës të akumulojë së paku 90 kredi profesionale për çdo të pestin vit.

Ekzistojnë dy forma të zakonshme për financimin e ZHVP-së në shumicën e sistemeve Evropiane: nga niveli qendror duke siguruar kurse falas për zhvillimin e mësimitdhënësve dhe financimin e shkollave. Në 24 sisteme Evropiane të arsimit, shkollat pranojnë fonde nga autoritetet publike për të paguar për Zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimitdhënësve. Në disa vende, ekziston një shumë e veçantë e rezervuar për ZHVP; në të tjera, shkollat janë të lira të vendosin se sa prej buxhetit të tyre të shpenzohet në ZHVP. Për shembull, në Republikën Çeke, buxheti për ZHVP është pjesë e pagesës së veçantë të përcaktuar për shkolla. Vet shkollat vendosin se sa të alokojnë për ZHVP bazuar në nevojat dhe rrethanat specifike të tyre dhe në përputhshmëri me planet zhvillimore të tyre.

Programet për kualifikimin e mësimitdhënësve në Kosovë ofrohen vetëm nga institucionet publike dhe duhet të akreditohen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Kurse të shkurtra të zhvillimit profesional duhet të akreditohen nga Këshilli i Mësimitdhënësve për Zhvillim Profesional. Mësimitdhënësit kërkohet të vijnë së paku 120 orë trajnimi për të mbajtur licencën e përkohshme të mësimitdhënies. Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2013 për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve delegon pjesë të përgjegjësisë të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve tek komunat. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2013 për financimin e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve përcakton që MASHT të delegojë shumicën e buxhetit për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve tek komunat me kushtin që ato demonstrojnë ekzistencën e projekteve dhe planeve konkrete për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe janë të bazuara në programe trajnimi nga institucionet e akredituara. Megjithatë, vetëm një numër i vogël i shkollave kanë qenë kompetente të ofrojnë planet të zhvillimit të kapaciteteve në nivel të shkollave (21 shkolla).

## Vlerësimi i performancës dhe licencimi i mësimit dhe mësuesve

Vlerësimi individual i mësimit dhe mësuesve përfshin formimin e një gjykimi rreth punës së mësimit dhe mësuesve në mënyrë që të udhëzojë dhe ndihmojë ata në përmirësimin e performancës së tyre. Ky vlerësim mund të ndodhë gjatë procesit të vlerësimit të shkollave, ose mund të realizohet në mënyrë të pavarur. Ekzistojnë disa forma të rregulluara të vlerësimit individual të mësimit dhe mësuesve në të gjitha sistemet e arsimit në Evropë, përveç në Itali, Finlandë dhe Norvegji. Procesi i vlerësimit merr parasysh faktor të ndryshëm dhe ndjek disa forma. Shumica e sistemeve evropiane marrin parasysh arritshmërinë e nxënësve, rezultatet e ekzaminimit të jashtëm (Portugalia), vlerësimi nga shkollat tjera (Lituani dhe Rumania). Në shumicën e vendeve drejtuesit e shkollave mbajnë përgjegjësi për vlerësimin e mësimit dhe mësuesve dhe kjo realizohet në baza të rregullta. Në Holandë, bordi i shkollës kryen vlerësimin individual të personelit. Vlerësimi sistematik i mësimit dhe mësuesve nga drejtuesi i shkollës është fuqizuar kohëve të fundit edhe në Slloveni (nga viti 2009) duke shtuar shpeshësinë e raportimit nga drejtuesit e shkollave. Në Sllovakia, është vendosur një formë e sistemit konsekuativë ku drejtuesi i shkollës vlerëson zëvendës drejtorin e shkollës, i cili pastaj vlerëson mësimit dhe mësuesit. Një mësimit dhe mësues në rolin e mentorit vlerëson mësimit dhe mësuesit fillestar.

Në shumë sisteme Evropiane të arsimit, vlerësuesit e jashtëm bëjnë vlerësimin e mësimit dhe mësuesve në baza të rregullta ose vetëm në rrethana të veçanta. Kjo ndodhë shpesh krahas procedurave të tjera sikurse vlerësimi nga drejtuesi i shkollës. Inspektorët e arsimit mbajnë përgjegjësinë kryesore për vlerësimin e mësimit dhe mësuesve në Francë, Luksemburg dhe Turqi. Vetëvlerësimi i mësimit dhe mësuesve nuk duket të jetë teknikë e përhapur e vlerësimit në vendet Evropiane. Në disa vende, vlerësimi i mësimit dhe mësuesve në baza individuale është sistem më kompleks me akterë të ndryshëm të përfshirë. Për shembull, në Portugali sistemi i ri vlerësimi i cili ka hyrë në fuqi në vitin shkollor 2011/12, përfshinë një komponent të brendshme dhe të jashtme. E para kryhet nga Këshilli Pedagogjik i shkollës dhe mbulon të gjithë mësimit dhe mësuesit. Vlerësimi i jashtëm realizohet përmes observimit të klasave nga vlerësuesit e jashtëm vetëm në situata specifike. Në vitin 2007 në Letoni është iniciuar zhvillimi i një strukture të diferencuar të karrierës si pilot projekt. Brenda kornizës së këtij pilot projekti, performanca e mësimit dhe mësuesve vlerësohet përmes shqyrtimit të vetëvlerësimit nga ekspertët e jashtë dhe nga administrata arsimore.

Në Kosovë, MASHT ka nxjerr një tjetër Udhëzim Administrativ (25/2014) për licencimin e mësimit dhe mësuesve. Qëllimi i instrumentit të ri ligjor ishte të krijohet një sistem koherent i licencimit të mësimit dhe mësuesve që është i bazuar në kualifikime, përvojë, zhvillimin profesional dhe performancë. Udhëzimi gjithashtu përcakton llojet e licencave dhe kriteret e licencimit. Udhëzimi i ri administrativ mishëron përkushtimin e MASHT-it për të ndërtuar në sistem që mbështet zbatimin e një sistemi të performancës dhe kualifikimit të bazuar në sistemin e pagave.

Megjithatë, sistemi i vlerësimit të performancës së mësimit dhe mësuesve nuk është zbatuar ende në Kosovë. Skema e pagave është e bazuar në kualifikimet para-shërbimit por jo në bazë të performancës. Një qasje e tillë është shkaku kryesor i mos zbatimit të sistemit të licencimit të mësimit dhe mësuesve, për shkak të mungesës së stimulimit. Sistemi, i cili tashmë është vendosur, mundëson një licencë të përkohshme dhe licencim të rregullt të mësimit dhe mësuesve (MASHT, 2014b). Mësimit dhe mësuesit me licencë të përkohshme (rreth 14% të mësimit dhe mësuesve ekzistues të cilët janë fillestar ose të pakualifikuar) duhet të përmbushin kriteret e kualifikimit dhe trajnimi për të fituar licencimin e rregullt ose rrezikojnë të humbin të drejtë e mësimit dhe mësuesve. Në të njëjtën kohë, mësimit dhe mësuesit me licencë të rregullt mund të promovohen përmes pesë gradave të karrierës. Mësimit dhe mësuesit duhet t'i nënshtrohen trajnimit dhe të marrin së paku një vlerësim pozitiv të performancës në një periudhë prej pesë vitesh për të kaluar nga një gradë në tjetrën.

## Pagësimi i mësimit dhe mësuesve dhe kushtet e punës

Për të krahasuar shpenzimet financiare të bëra nga autoritetet kompetente për të paguar mësimit dhe mësuesit, një prej treguesve më të zakonshëm është raporti i pagave statutores minimale dhe maksimale me Bruto Produktin Vendor për kokë banori (BPV), një indikator i standardit të jetesës së një

popullate të një vendi. Në shumicën e vendeve Evropiane, pagat mesatare e mësimdhënësve në arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm janë më të ulëta sesa BPV për kokë banori. Norma më e ulët vërehet në Letoni, Lituani, Rumani dhe Sllovakia ku paga minimale e mësimdhënësve të arsimit fillor korrespondon me 65% të BPV-së për kokë banori. Paga e mësimdhënësve në Kosovë është dukshëm më e lartë se sa BPV vjetore për kokë banori (145 përqind) dhe është në mesin e vendeve të pakta Evropiane që ofrojnë shpërblime gjeneroze (Gjermania, Turqia, Portugalia).

**Tabela 8 - Të ardhura mesatare vjetore të mësimdhënësve krahasuar me BPV vjetore për kokë banori, 2013**

Letoni	Sllovakia	Estoni	Lituani	Kosovë	Turqi	Gjermani
60%	60%	78%	81%	145%	165%	176%

Burimi: EUROSTAT, MASHT/MAP 2014

Në shumicën e vendeve Evropiane, është gjithashtu përcaktuar një numër i përgjithshëm i orëve të punës, bazuar në masën e kohës së punës në sektorët tjerë të punësimit. Kjo është ndërmjet 35 dhe 40 orë në të gjitha vendet Evropiane, siç është përcaktuar me marrëveshjen kolektive ose marrëveshje të tjera. Në rreth një të tretën e vendeve Evropiane, koha që mësimdhënësit duhet të jenë në shkolla secilën javë është po ashtu e përcaktuar dhe në përgjithësi nuk kalon 30 orë, përveç në Portugali, Suedi, Mbretëri të Bashkuar dhe Norvegji. Orët javore të mësimdhënies rangohen nga 12 orë për javë në po aq shumë sa 36 javë për javë. Ndryshimet brenda vendeve dhe niveleve të arsimit kanë të bëjnë me numrin minimal dhe maksimal të orëve të mësimdhënies, ose dallime të bazuara në lëndët e dhëna dhe përvojën e punës së mësimdhënësve. Mesatarja e kohës së punës së mësimdhënësve në Kosovë është 20 orë për javë. Norma e mësimdhënies është e ulët në krahasim me shpërblimin që tregon se licencimet e ardhshme dhe rritjet e pagave duhet të analizohen me kujdes si pjesë e studimit gjithëpërfshirës të optimizimit të mësimdhënësve. Kostoja mesatare vjetore për mësimdhënës në Kosovë është 5230 Euro dhe është shumë më lartë se sa BPV vjetore për kokë banori. Rritjet e mëtutjeshme lineare duhet të mënjanojnë sepse dekurajojnë përmirësimet cilësore dhe duhet të lidhen ngushtë me vlerësimin e performancës dhe sistemin e licencimit.

### Sistemi i llogaridhënies

Është e vështirë të fillohet një proces reformimi ose të fillohet përmirësimi i rezultateve të studentëve në mungesë të një sistemi monitorimi. Sistemet nuk mund të përmirësojnë atë që nuk është e matshme. Monitorimi i rezultateve mundëson sistemet e arsimit të identifikojnë dhe të vendosin praktikatat më të mira. Sistemet e avancuara të arsimit në Evropë dhe më gjerë kanë vendosur mekanizma për monitorimin e cilësisë të mësimdhënies dhe të mësuarit. Në mënyrë që të rritet llogaridhënia publike dhe të shtohet siguri i cilësisë shumica e sistemeve bëjnë tri gjëra njëkohësisht: zbatojnë ekzaminimin e jashtëm të studentëve, kryejnë vlerësime të rregullta të shkollave dhe ndërtojnë sisteme të avancuara të të dhënave.

### Ekzaminimi i jashtëm i studentëve/nxënësve

Ekzaminimi i jashtëm i nxënësve do të testonte nxënësit për njohuritë e tyre, mundëson të kuptuarit nëse ata kanë arritur rezultatet e të mësuarit. Rezultatet e nxënësve analizohen në hollësi të mëdha në nivelin e qeverisë lokale, shkolla dhe nivelin individual. Ekzaminimet janë një masë e fuqishme në shtytjen e performancës së shkollës. Shumica e sistemeve Evropiane të arsimit zbatojnë ekzaminime kombëtare dhe ndërkombëtare dhe i krahasojnë rezultatet e tyre me sistemet me performancë të lartë. Në Kosovë, Ministra zbaton tre sisteme të ekzaminimit të jashtëm: (1) provimi kombëtar i maturës – ekzaminimi dalës për nxënësit që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, (2) provimi i semi maturës 0 për nxënësit që kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët, (2) provimi i arsimit fillor.

Sistemi i ekzaminimit të jashtëm është i pazhvilluar, i mungon kredibiliteti dhe të dhënat nuk janë të besueshme. MASHT kishte vështirësi në garantimin e administrimit të duhur të sistemit të testimit. Së dyti,

.....

testimet janë të bazuara në lëndë por jo në rezultate dhe nuk reflektojnë dispozitat e kornizës së kurikulës. Së fundi, të dhënat e ekzaminimit të studentëve nuk janë analizuar në formë të rregullt por as nuk janë shfrytëzuar sistematikisht për të informuar veprimet e politikave. Kosova ka marr pjesë në studimet e testimit ndërkombëtar të studentëve. Një pilot i Programi Ndërkombëtar të Vlerësimit të Studentëve (PISA) është realizuar në vitin 2015 dhe rezultatet do të jenë të njohura në vitin 2016. Kosova nuk ka regjistruar ndonjë pjesëmarrje qoftë në Programin Ndërkombëtar të Studimit të Shkrim Leximit (PIRS) ose në Studimin e trendëve Ndërkombëtare në Matematikë dhe Shkencë (TIMSS).

### **Vlerësimet e shkollave dhe garantimi i cilësisë**

Vlerësimi i shkollave ose inspektimet vlerësojnë performancën e shkollave kundrejt një modeli të indikatorëve. Ato reflektojnë si në rezultate ashtu edhe në proceset që i udhëheqin ato. Në shumicën e sistemeve të avancuara Evropiane të arsimit, përgjegjësia për vlerësimin e rezultateve dhe realizimin e inspektimeve qëndron tek Inspektorati i pavarur i arsimit. Ndërtimi i kapaciteteve të inspektoratit të arsimit dhe praktikat e vlerësimit të jashtëm të shkollave është treguar si element kyç i qasjes së garantimit të cilësisë në shumicën e sistemeve Evropiane të arsimit.

***Në shumicën e vendeve Evropiane, inspektoratet e nivelit qendror të arsimit janë përgjegjës për vlerësimin e jashtëm të shkollave.*** Në rastin e Kosovës, Inspektorati i Arsimit deri vonë ka qenë vetëm një departament në kuadër të MASHT-it. Megjithatë, sipas ligjit të ri për inspektoratin e arsimit, ky organ do të bëhet agjenci e pavarur. Procesi i transformimit nga një departament në organ të pavarur ka qenë i ngadalshëm për shkak të kufizimeve në burime. Organi ka qenë jashtë shqyrtimit në shumicën e nismave për ngritje të kapaciteteve në Kosovë. Aktualisht ka një numër të vogël të inspektorëve në nivelin qendror dhe rajonal. Ndër praktikat më të mira Evropiane, në Danimarkë, Lituan, Angli, Estoni, inspektoratet janë Agjenci të Pavarura dhe japin përgjegjësi Parlamentit ose bordeve të jashtme të arsimit. Ato zbatojnë mandatin e tyre në bashkëpunim me autoritetet e nivelit rajonal dhe kontrollojnë pikërisht përvojën dhe kualifikimet e personelit. Italia dhe Islanda përfshijnë profesionist të jashtëm në bashkëpunim me inspektorët e arsimit në praktikat e jashtme të ekzaminimit.

***Kriteret e shfrytëzuara në vlerësimin e jashtëm të shkollave*** shpesh janë tepër të standardizuara. Në shumicën e rasteve, vlerësimet e jashtme të shkollave përqendrohen në një varg të gjerë të aktiviteteve të shkollave, duke përmblodhur detyra arsimor dhe menaxheriale, rezultatet e studentëve, si dhe përputhshmërinë me rregulloret. Për të përkrahur punën e tyre, vlerësuesit mbështeten në një kornizë të përcaktuar nga niveli qendror e cila vendos në një formë të strukturuar dhe të njëtrajtshme jo vetëm pikat e kontaktit të vlerësimit të jashtëm por gjithashtu edhe standardet për përcaktimin e një shkolle 'të mirë'. Disa qasje të vlerësimit të jashtëm të shkollave fokusohen vetëm në aspekte specifike të punës së shkollave sikurse pajtueshmëria me rregulloret (Estonia, Sllovenia dhe Turqia). Pjesa më e madhe e procesit të vlerësimit të jashtëm në Danimarkë, është zhvilluar nga komunitatet përkatëse, me përkrahjen e autoriteteve të nivelit qendror. Inspektorati i Arsimit në Kosovë nuk është e njohur të ketë një kornizë për vlerësimin e jashtëm. Kryesisht puna e tij është bazuar e paplanifikuar (ad hoc) dhe në shumicën e rasteve e kufizuar për të reaguar ndaj çështjeve që ngritën. Fushëveprimi i tij ka qenë kryesisht i fokusuar në çështje administrative dhe të punësimit.

***Procedurat për vlerësimin e shkollave*** në Evropë përfaqësojnë një pasqyrë më homogjene. Përkundër dallimeve në fushën dhe numrin e aktiviteteve të vlerësuara, zbatimi i vlerësimit të jashtëm të shkollave përgjatë Evropës është i bazuar në një strukturë tepër homogjene e cila përbëhet nga tre hapa: (1) analiza; (2) vizita; dhe (3) raportime. Të gjitha vendet me vlerësime të jashtme kanë procedura të cilat e reflektojnë këtë kornizë. Përveç kësaj, një varg i gjerë dhe i pasur i instrumenteve është në dispozicion të vlerësuesve në shumicën e sistemeve të arsimit, duke ofruar mundësi për burime të shumëfishta të informatave, duke shtuar dialogun me akter përkatës dhe duke arritur konkluzione transparente dhe të bazuara në të dhëna. Disa sisteme kryejnë inspektime vjetore në të gjitha shkollat, disa zgjedhin një mostër të rastësishme të shkollave secilin vit, ndërsa sisteme të tjera e bëjnë këtë



.....

secilin vit të tretë deri në të katërtin. Inspektorati në Kosovë nuk zbaton një qasje sistematike për vlerësim dhe nuk përfshinë procedura të standardizuara. Disa nivele të kontrollit të aspekteve të caktuara janë shënuar është vështirë të dallohet arsyeshmëria, kontributi i tyre në cilësi dhe gjerësia e aplikimit të tyre. Procedurat për vlerësimin e shkollave në Kosovë nuk janë të zhvilluara mirë dhe të zbatuara në mënyrë sistematike.

Sistemet e avancuara Evropiane po ashtu **zbatojnë aktivitete vijuese duke publikuar rezultatet e inspektimit të shkollave dhe duke profilizuar shkollat me performancë të ulët**. Shumica e sistemeve publikojnë të gjeturat e inspektoratit dhe i ndajnë ato me hisedar (qeveria, mediat dhe prindërit). Në gjashtë sisteme të arsimit (Danimarkë, Irlandë, Holandë, Suedi dhe Mbretëri të Bashkuar), një qasje e bazuar në rrezik është prezantuar viteve të fundit. Kjo metodë shfrytëzohet për të fokusuar punën e vlerësuesve në shkolla të cilat nuk performojnë në standardin e pritur. Në një numër të sistemeve të arsimit (Franca, Lituania, Polonia), vlerësimet e jashtme nuk janë synuar të gjejnë vetëm të metat në performancën e shkollave, por gjithashtu të shtoj vizibilitetin e atyre që performojnë mirë dhe arrijnë rezultate të mira. Qasja e përdorimit të vlerësimit të jashtëm si një instrument për identifikimin dhe dhënies së vizibilitetit në praktikën e mira mundëson grumbullimin dhe ndarjen e fakteve mbi funksionimin dhe në cilat rrethana me kthime pozitive si në nivelin e shkollës ashtu edhe të sistemit.

## **Masat e rekomanduara të reformës**

**Regjistrimi i rritur në arsimin parashkollor ka potencial të zvogëloj pabarazitë në fazat e hershme të jetës dhe të nivelizoj hapësirën e veprimit për studentët e marginalizuar.** Të dhënat nga PISA tregojnë se një fillim i hershëm në shkollimin fillor është i lidhur ngushtë me rezultate më të larta të të lexuarit në arsimin fillor dhe të mesëm. Të dhënat globale tregojnë se ofrimi i arsimit cilësor parashkollor është më rëndësi për promovimin e zhvillimit social, emocional, fizik dhe njohës të fëmijëve; po ashtu rrit gatishmërinë e shkollave, që ndihmon në mësimnxënie (Heckman dhe Lafontaine 2010; Heckman 2008; Engle et al. 2011). Mungesa e shkathtësive njohëse fillon të shfaqet herët dhe pabarazitë për qasje në arsimin parashkollor zgjerojnë hendekun e të mësuarit. Literatura për zbërthimin e rezultateve të studentëve në PISA përmes grupeve (Amermueller 2004) dhe viteve (Barrera et al. 2011) ka gjetur se performanca e nxënësve në PISA është rritur për 10 pika në PISA për secilin vit të kaluar në arsimin parashkollor.

Cilësia e rezultateve të arsimit varet në faktorë të ndryshëm por **mësimdhënësit ndoshta përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të këtij vargu**. Trajnimi dhe certifikimi përfaqëson sfidat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Mësimdhënia me cilësitë të ulët është shkak i vetëm më i rëndësishëm i cilësisë së ulët të mësimnxënies që kontribuon në mënyrë jo proporcionale në performancë të dobët. Prandaj, rekomandimi kryesor i politikave ka të bëjë më përmirësimin e sistemit të licencimit të mësimdhënësve.

Cilësia e mësimdhënies dhe të mësuarit është e lidhur ngushtë me **funksionimin efektiv të mekanizmave të garantimit të cilësisë** në nivelin qendror, lokal dhe shkollor. Sigurimi i cilësisë në arsim nënkupton garantimin e një qeverisjeje gjithëpërfshirëse dhe kornize institucionale e cila përmirëson llogaridhënien nga prindërit mbi atë se çfarë ndodhë në shkolla (drejtpërdrejt si dhe përmes organeve të zgjedhura dhe përmes ekzekutivit). Kosova aktualisht nuk ka Sistem funksional të Sigurimit të Cilësisë, dhe krijimi i një sistemi të fillë konsiderohet si një prej prioriteteve kryesore të Sistemit të Arsimit Para-Universitar. Testet kombëtare të vlerësimit janë të lidhura ngushtë me Sistemin e Sigurimit të Cilësisë, duke qenë se ato vlerësojnë rezultatet e mësimnxënies. Kosova pritet të fitoj qasje në instrumentet e njohura ndërkombëtare të vlerësimit, sikurse PISA, i cili do të ofroj të dhëna shtesë mbi cilësinë e arsimit dhe do të mundësoj krahasimin me vendet tjera. Duke qenë se vlerësimi kombëtar përmirësohet dhe rezultatet bëhen më të besueshme, pritet të gjenerohen më shumë fakte për arsyetimin e nevojës për të siguruar cilësinë e ofrimit të arsimit në nivelin e shkollave, atë lokal dhe qendror.



E shfrytëzuar për të përkrahur të dy aspektet, mësimdhënien dhe mësimnxënien, **Teknologjia Informativë dhe Komunikimit plotëson klasat** me mjete digjitale të të mësuarit, sikurse kompjuter dhe pajisje të dorës; zgjeron ofertat, ndërveprimin dhe përvojën e kursit dhe materialet e të mësuarit; ndërton shkathtësi të shekullit 21; rrit angazhimin dhe motivimin e nxënësve; bënë shkollën prapë atraktive; dhe nxit të mësuarit. Promovimi i shfrytëzimit të TIK në shkolla është mënyra më e mirë për të siguruar fëmijëve dhe studentëve me teknologjinë e munguar arsimor dhe lehtësirave të mësimdhënies, dhe të motivojë ata në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

### Masa 1: Të rritet përfshirja në arsimin para-shkollor dhe para-fillor për të përmirësuar arritshmërinë e nxënësve

Vijimi i arsimit para-fillor për më tepër se një vit ndikon në arritjet e nxënësve – arsimi para-shkollor ka potencial të zvogëlojë pabarazitë në jetën e hershme dhe të nivelizoj hapësirën e të vepruarit për studentët e margjinalizuar. Analizimi i OECD të rezultateve të PISA-së tregon se një fillim i hershëm në shkollimin fillor është i lidhur ngushtë me rezultate më të larta në lexim. Të dhënat globale (shiko seksionin e parë) dëshmojnë se ofrimi i arsimit cilësor para-shkollor është me rëndësi për promovimin e zhvillimin social, emocional, fizik dhe njohës të fëmijëve dhe do të ndikoj pozitivisht në arritjet e nxënësve në faza të mëvonshme. Norma e regjistrimit bruto në arsimin para-fillor në Kosovë aktualisht janë 75 përqind, përderisa shkalla e regjistrimit të përgjithshëm bruto në arsimin parashkollor (3-5 vjeçar) është 26 përqind.




Figura 8 - SHBR në arsimin para fillor dhe atë fillor 2008-2014

### Veprimi 1: Të rritet përfshirja në arsimin para-fillor me 5000 fëmijë shtesë

Numri i nxënësve në arsimin para-fillor është rreth 21,000 në vitin shkollor 2014/2015. Regjistrimi ekzistues bruto prej 76 përqind mund të përmirësohet dukshëm përmes një iniciative të re për të rialokuar burimet e mësimdhënies nga nivelet me të larta të arsimit, përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe aktivitete vetëdijësuese. Përfshirja e 5000 nxënësve shtesë në arsimin njëvjeçar para-fillor mund të kontribuoj ndjeshëm në arritjet e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm. Për këtë nuk janë të nevojshme investime të mëdha infrastrukturore ngase kapacitetet ekzistuese lirohen nga efekti i shkallës më të ulët të lindjeve. Numri i fëmijëve në arsimin fillor dhe të mesëm është 10 përqind më i ulët këtë vit se sa katër vite më parë. Personeli mësimdhënës tashmë është duke dëshmuar numër më të vogël të nxënësve për mësimdhënës dhe jo-domosdoshmërisht kërkon mësimdhënës shtesë – disa rivendosje të fuqisë punëtore të mësimdhënësve mund të jetë e nevojshme.

Tabela 9 - Të rritet përfshirja në arsimin para-fillor me 5000 fëmijë shtesë

	2011/2012
<b>Nxënësit (5 vjeçar) në arsimin para-fillor</b>	20875
<b>Numrat shtesë</b>	5000
<b>Popullata në moshën 5 vjeçare</b>	29436
<b>Numri i mësimdhënësve</b>	0
<b>Infrastruktura</b>	Optimizimi i shkollave

### Veprimi 2: Të rritet përfshirja në arsimin para-shkollor (3-4 vjeçare) me 5000 fëmijë shtesë

Numri i nxënësve në arsimin para-shkollor është rreth 5380 në vitin shkollor 2014/2015. Regjistrimi ekzistues bruto i moshës 3 dhe 4 vjeç është rreth 18 përqind. Bruto regjistrimi në arsimin para-shkollor mund të përmirësohet dukshëm përmes një iniciative të re për të shkurtuar numrin e mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm duke marr parasysh uljen e numrit të nxënësve dhe rialokimin e tyre në nivelet parashkollore. Rivendosija e kapaciteteve të mësimdhënësve mund arrihet përmes shfrytëzimit maksimal të mësimdhënësve (shiko masën për mësimdhënësit). Komunitat do të duhej të zbatonin një politik të mos-zëvendësimit të mësimdhënësve të pensionuar në nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm dhe në vend të kësaj të shfrytëzojnë këtë burime për të rekrutuar 450 edukator për çdo vit. Investimet në infrastrukturë mund të zbatohen përmes marrëveshjeve të ndarjes së kostos (MASHT, DKA) dhe partneritetit publiko privat.

Tabela 10 - Të rritet përfshirja në arsimin para-shkollor (3-4 vjeçare) me 5000 fëmijë shtesë

	2014/2015
<b>Popullata në moshën 3 vjeçare</b>	29414
<b>Popullata e moshës 3 vjeçare në arsimin parashkollor</b>	5380
<b>Popullata në moshën 4 vjeçare</b>	28858
<b>Numra shtesë</b>	5380
<b>Kostoja e përgjithshme financiare (360 Euro për nxënës)</b>	2,300,000
<b>Kursimet nga shfrytëzimi i optimal i mësimdhënësve</b>	2,700,000
<b>Numri i mësimdhënësve të rinj</b>	450 përmes shfrytëzimit optimal
<b>Infrastruktura</b>	Ndarja e kostos me Komuna

Tabela 11 – Masa e politikave #1.1.1

Aktiviteti	Produkti	Rezultati
<p><b>Masa e politikave #1.1.1</b></p> <p><i>Rritja e regjistrimit në arsimin para-shkollor dhe para-fillor</i></p> <p><b>Kostoja e llogaritur:</b> 4 milion €</p>	<p>Komunitat kanë mundësi të përfshijnë 5000 fëmijë shtesë në arsimin para-fillor</p> <p>Komunitat kanë mundësi të përfshijnë 5000 fëmijë shtesë në arsimin para-shkollor</p>	<p>Rezultate të përmirësuara të fëmijëve në arsimin fillor</p> <p>Rezultate të përmirësuara të fëmijëve në vlerësimet kombëtare dhe të jashtme</p>
<p>1) Të përfshihen 5000 fëmijë të moshës 3-4 vjeçare në arsimin para-shkollor;</p> <p>2) Të përfshihen 5000 fëmijë shtesë të moshës 5 vjeçare në arsimin para-fillor</p> <p>3) Të rekrutohen 450 edukator shtesë për çdo vit përmes kapaciteteve përmes shfrytëzimit optimal të mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm</p> <p>4) Investime shtesë në infrastrukturë përmes marrëveshjeve të ndarjes së kostos dhe sektorit jo-qeveritar</p>		

## Masa 2: Ngritja e cilësisë së mësimdhënies për rezultate më të mira të nxënësve

### Veprimi 1: Programi për rikualifikimin e mësimdhënësve

Të dhënat lidhur me kualifikimin e mësimdhënësve (shiko seksionin për Mësimdhënësit) tregojnë se kualifikimet në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët janë dukshëm nën praktikën Evropiane. Rreth 62 përqind e mësimdhënësve në arsimin fillor nuk kanë nivel të kualifikimit bachelor. Situata është e ngjashme në arsimin e mesëm të ulët ku 45 përqind e mësimdhënësve janë të nën-kualifikuar. MASHT tashmë ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ për rregullimin e normativës së kualifikimeve. Rreth 2000 mësimdhënës me kualifikime të Larta Profesionale, jo terciare do të kenë nevojë të hyjnë në programe të kualifikimit të bazuar në lëndë në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës. Ky aktivitet është thelbësor për avancimin e shkathtësive përmbytësore dhe pedagogjike të mësimdhënësve të pa-kualifikuar. Do të ndikonte shumë cilësinë e mësimin dhe arritjeve të nxënësve (shiko ndikimi i kualifikimit të mësimdhënësve në cilësi, në seksionin 1).

### Veprimi 2: Shfrytëzimi optimal i mësimdhënësve

Kosova është duke përjetuar efektin demografik në numrin e fëmijëve në arsimin para-universitar. Shkalla e ulët e lindjeve gjatë këtyre dhjet viteve po ndihen përmes rënies së shpejtë të numrit të fëmijëve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë (shiko seksionin mbi Analizimin e gjendjes). Si rezultat i kësaj norme e mësimdhënësve për nxënës ka rënë. Duke marrë parasysh faktet e pazëvendësueshme që theksojnë se numrat plotësues të nxënësve për mësimdhënës nuk kanë ndonjë rezultat të domethënës në arritjet e nxënësve dhe politikat prioritare konkurruese për kapacitete shtesë të mësimdhënies në arsimin para-shkollor, është e nevojshme një iniciativë e re për shkurtrimin numrit të mësimdhënësve (shfrytëzimi optimal i kapaciteteve të mësimdhënësve). Masa mund të zbatohet duke mos zëvendësuar numrin e mësimdhënësve të pensionuar në baza vjetore (përafërsisht 450). Mos zëvendësimi është një masë e butë e politikave që mund të tejkaloj kundërshtimet politike. Kursimet (2.7 milion për çdo vit) nga nisma për shfrytëzimin optimal të mësimdhënësve mund të dedikohen për rekrutimin e 450 edukatorëve shtesë në nivelin para-shkollor në baza vjetore.

Tabela 12 – Iniciativa për shfrytëzimin optimal të mësimdhënësve

	2015	2016	2017	2018	2019
<b>Numri i nxënësve</b>	372,372	362,532	353,455	344,662	336,141
<b>Numri i mësimdhënësve në arsimin para-universitar</b>	22952	22952	22952	22952	22952
<b>Normat e projektuara</b>	16.2	15.7	15.3	15	14.6
<b>Numri i mësimdhënësve pas optimizimit</b>		22378	21818	21275	20749
<b>Mesatarja e mësimdhënësve të pensionuar secilin vit</b>		544	544	544	544
<b>Numri i mësimdhënësve që nuk zëvendësohen në shkallën 16.2</b>		574	560	543	526
<b>Kursimet në milion prej 5360 Euro në çdo vit për mësimdhënës</b>		2,91	2,91	2,91	2,91

### Veprimi 3: Skema e pensionimit të hershëm të mësimdhënësve me aftësi të kufizuara

Dispozitat ekzistuese ligjor lidhur me punësimin e mësimdhënësve nuk përcaktojnë ndonjë skemë të pensionimit të hershëm për mësimdhënësit. Megjithatë, bazuar në intervistat me zyrtarët e MASHT-it kjo nismë është garantuar duke marrë parasysh një listë të përafërsisht 100 mësimdhënësve me paaftësi të ndryshme (dëmtime pamore, probleme më dëgjim, paaftësi fizike). Shumë prej këtyre mësimdhënësve kanë vazhduar të punojnë për të mbajtur një burim themelor të të ardhurave. Kosova duhet të lansoj këtë nismë të njëhershme për të larguar këta mësimdhënës nga kuadrot. Një mënyrë për të bërë këtë

.....

është ofrimi i mundësisë për rastet më të rëndë mbi moshën 55 vjeçare. Në shumë raste Evropiane dhe ndërkombëtare të konsultuara, mësimdhënësit e tillë do të mbanin të drejtën për të kërkuar 75 përqind të pagës origjinale deri në pensionim. Kjo politikë mund të rregullohet përmes një Udhëzimi Administrativ të veçantë në bashkëpunim me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Humbja e të ardhurave publike është shumë më e ulët ndaj kostos që një mësimdhënës me paaftësi i ngarkon mesimxënies dhe arrijtes së studentëve.

Tabela 13 - Skema e pensionimit të hershëm të mësimdhënësve me aftësi të kufizuara

<b>Numri</b>	<b>100</b>
<b>Pagesa e pensionimit të hershëm</b>	75%
<b>Shpenzimet vjetore për mësimdhënës</b>	5360 Euro
<b>Kostoja për njësi (75%)</b>	4020
<b>Kostoja totale vjetore</b>	402,000

#### **Veprimi 4: Vlerësimi i performancës dhe sistemi i licencimit të mësimdhënësve**

Një skemë funksionale dhe disi konkurruese e karrierës është parakusht themelor për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, ngase motivon mësimdhënësit që në vazhdimësi të përmirësojnë performancën e tyre. Në anën tjetër, një sistem licencimi i strukturuar mirë me rrjedhje të përshtatshme të informatave i mundëson autoriteteve me informata relevante për cilësinë e ofrimit të arsimit në shkolla. Sistemi ekzistues i licencimit të mësimdhënësve kërkon nga mësimdhënësit të fitojnë një numër të caktuar të krediteve nga programet zyrtare të zhvillimit të mësimdhënësve dhe t'i nënshtrohen një procesit të vlerësimit të performancës për të fituar një prej katër llojeve të licencës së rregullt: licenca e karrierës; licenca e avancuar; licenca për mentor dhe licencë e merituar (MASHT, 2014b). Procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve përbëhet nga vetëvlerësimi (10%), vlerësimi nga drejtuesi i shkollës (30%) dhe vlerësimi nga Inspektorati i arsimit (60%), kjo e fundit bazuar në monitorimin në klasa dhe vlerësimin e planifikimit të mësimve. Siç është paraqitur më lartë, kapacitetet e kufizuara të inspektoratit të arsimit dhe politika e pagës fikse kanë qenë pengesat kryesore në zbatimin e sistemit të licencimit të mësimdhënësve.

Inspekcioni i arsimit ka më pak se 60 punëtorë në tërë Kosovën dhe duhet të trajtojë një numër të madh të çështjeve administrative (Ligji, 2004). Me këtë qasje dhe këto burime, është e pamundur të bëhet vlerësimi dhe jepen rekomandimet për të gjithë personelin e mësimdhënësve. Disa përmirësime mund të ndërmerren duke rekrutuar ekipe të ekspertëve ose duke kontraktuar procesin subjekteve publike ose private të specializuara në zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Si zgjidhje alternative, mund të krijohet një njësi e veçantë për vlerësimin e performancës në kuadër të MASHT-it ose Inspektoratit të Arsimit dhe të plotësohet me personel të nevojshëm, por prapë mund të marr vetëm rol administrativ dhe duhet të mbështetet në ekspertizën e jashtme.

Qeveria duhet të prezantoj një skemë të re të pagesës së mësimdhënësve të ndërlidhur me promovimin përmes procesit të licencimit. Rritja e mëtejshme lineare e pagave duhet të mënjanohet, për shkak se shteron financimin e arsimit dhe nuk kontribuon në përmirësimin e mësimdhënies në shkolla. Sistemi i licencimi përbëhet nga dy lloje të licencave: të rregullta dhe të përkohshme. Qeveria mund të konsideroj zbatimin e sistemit të rregullt të licencimit (shiko seksionin mbi vlerësimin e mësimdhënësve) duke dhënë 16000 licenca të rregullta për mësimdhënësit që aktualisht plotësojnë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për normativën e mësimdhënësve. Rreth 8000 licenca të avancuara mund të jepen pa ndonjë implikim financiar duke marr parasysh rritjet e fundit të pagave. Një numër tjetër prej 5000 licenca të avancuara potencialisht mund të përfshijnë një rritje të pagës prej 10%. Licencat për mentor mund të përfshijë 2500 mësimdhënës me kualifikim të lartë dhe mund të përbëj një rritje të pagës prej 20 përqind. Në fund, grada meritore mund të rezervohet për 500

mësimdhënës ekzistues për kualifikimet e larta, përvojën dhe kontributet e jashtëzakonshme dhe mund të përfshijë një rritje të pagës prej 30 përqind (shiko tabelën në vijim).

Tabela 14 – Skenari 1: Implikimet vjetor të kostos për sistemin e licencimit të mësimdhënësve

Grada	Nuk ka promovime	% e rritjes së pagës	Mesatarja e kostos vjetor për njësi në 5360 kosto vjetore për njësi	Kostoja totale vjetore në mil Euro.
Meritore	500	30%	1608	0.8
Mentor	2500	20%	1072	2,7
E avancuar	5000	10%	500	2,5
E rregullt	8000	0	0	0
E përkohshme	7480	0	0	0

Me miratimin e rregullores, qeveria duhet të krijoj kapacitetet për të menaxhuar vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, duke përfshirë kapacitetet administrative të MASHT-it dhe Inspektoratit të Arsimit, dhe kapacitetet profesionale të ekspertëve të jashtëm. Këto aktivitete duhet të ndërmerren një vit para funksionalizimit të plotë të sistemit. Duke marr vlefshmërinë 5 vjeçare të licencës, secili vit mund të procedoj rreth 5000 mësimdhënës. Në mënyrë që të përballohet kostoja e licencimit dhe duke marr parasysh efektin e licencimit në paga, është arsyeshme që aplikimet të përfshijnë një taksë të vogël.

Tabela 15 – Masa e politikave #1.1.2

Aktiviteti	Produkti	Rezultati
<p><b>Masa e politikave #1.1.2</b></p> <p><i>Sistemi i zhvilluar plotësisht i licencimit të mësimdhënësve është vendosur</i></p> <p>Programi i rikualifikimit të mësimdhënësve për lëndët programore dhe didaktikë.</p>	<p>Sistemi i njohjes së trajnimit në shërbim të mësimdhënësve është plotësisht funksional</p> <p>Sistemi i pagave i bazuar në licencim është vendosur</p> <p>2% të mësimdhënësve të promovuar si meritore</p> <p>10% promovohen si mësimdhënës mentor</p> <p>20% promovohen si mësimdhënës të avancuar</p> <p>35% promovohen si mësimdhënës të Rregullt</p> <p>500 mësimdhënës përfshihen në programin e rikualifikimit</p>	<p>Përmirësim i cilësisë së mësimdhënies</p> <p>Çdo vit se paku 30% të mësimdhënësve praktikues vijnë një formë të zhvillimit profesional</p>
<p><b>Kostoja e llogaritur:</b></p> <p>11 mil. € vjetore</p> <p>Vendosja e skemës së njëhershme të pensionimit të hershëm për mësimdhënësit me paafërsi</p> <p>Shfrytëzimi optimal i numrit të mësimdhënësve për të shkurtuar numrin e mësimdhënësve në arsimin para-universitar.</p>		

### Masa 3: Rritja e llogaridhënies dhe praktikës së sigurimit të cilësisë

Sigurimi i cilësisë në arsim duhet të jetë përgjegjësi e ndarë e komunave të përfaqësuara nga DKA-të dhe Inspektorati i Arsimit që përfaqëson qeverinë qendrore. Me 1148 institucione të arsimit para-universitar dhe 23,855 mësimdhënës nuk është e mundur të mënjanohet një ndarje e tillë e përgjegjësi. Nëse komunat nuk do të kishin rolë ose rolë të pakët në sigurimin e cilësisë, inspektorët do të duhej të ofronin përkrahje të drejtpërdrejt dhe këshilla për mësimdhënësit dhe shkollat. Nga kjo perspektivë, duke shumë e vështirë të imagjinohet se si do të funksionoj sistemi nëse shkollat janë në pronësi të komunave dhe pothuajse nuk ofrojnë aspak përkrahje për ato për të garantuar cilësinë. Gjithashtu, për shkak të natyrës së decentralizimit të sistemit të shkollave, autoritetet komunale janë

përgjegjës ndaj elektoratit të tyre për performancën e shkollave publike.

Cilësia e të mësimdhënies dhe të mësuarit është e lidhur ngushtë me funksionimin efektive të mekanizmave të sigurimit të cilësisë në nivelin qendror, lokal dhe atë të shkollave. Sigurimi i cilësisë në arsim nënkupton sigurimin e qeverisë gjithëpërfshirëse dhe kornizën institucionale e cila përmirëson llogaridhënien nga prindërit mbi atë se çfarë ndodhë në shkolla (drejtpërdrejt si dhe përmes organeve të zgjedhura dhe ekzekutivit. Kosova aktualisht nuk ka sistem funksional të sigurimit të cilësisë, dhe krijimi i një sistemi të tillë është konsideruar së një prioritet i lartë i Sistemit të arsimit para-universitar.

### Veprimi 1: Vlerësimi i shkollave: vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm

Më marrjen e një roli më të fuqishëm të DKA-ve në sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit para-universitar, mekanizmat e Sigurimit të Cilësisë në shkolla dhe DKA do të funksiononin në një mënyrë më të koordinuar dhe do të plotësonin njëra tjetrën. Për shembull, DKA mund të krijojë ekipe të praktikantëve në mesin e edukatorëve lokal për të mbështetur proceset e sigurimit të cilësisë në shkolla, nën përgjegjësinë e komunës. Ekipe të tilla dhe personeli i DKA-së do të mbështesnin shkollat në baza ditore, ndërsa roli i Inspektoratit të Arsimit do të ishte realizimi i vlerësimeve periodike institucionale të jashtme dhe të identifikojë fushat prioritare për përmirësim, të cilat u janë komunikuar shkollave si dhe në formë të zbërthyer tek departamentet përkatëse në MASHT. Kjo qasje do të kërkonte rekrutime shtesë në disa komuna, ose rishpërndarje të detyrave ndërmjet personelit të DKA-së, në atë mënyrë që ajo pjesë e tyre të ketë mundësi të kryej funksionin e Sigurimit të Cilësisë. Në mënyrë që të realizohen vlerësimet e jashtme institucionale, Inspektorati i Arsimit mund të ketë nevojë të rekrutojë personal shtesë të specializuar në aspekte të ndryshme të përmirësimit të shkollave ose të krijojë ekipe të ekspertëve në bazë të rasteve për të kryer këto detyra.

Tabela 16 – Masa e politikave #1.1.3

	Aktiviteti	Produkti	Rezultati
<b>Masa e politikave #1.1.3</b>	Ndërtimi i kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit, DKA-ve dhe shkollave për kryerjen e funksionit të Sigurimit të Cilësisë përmes:	Inspektorati i Arsimit ka kapacitete për të kryer vlerësimin e jashtëm të 20% të institucioneve të arsimit para-universitar për secilin vit	Rezultate të përmirësuar të shkollave në vlerësimin kombëtar
<b>Mekanizma efektiv të sigurimit të cilësisë janë vendosur në nivelin qendror, lokal dhe atë të shkollave</b>	1) Zhvillimit të rregullativës mbi ndarjen e përgjegjësisë të Sigurimit të Cilësisë ndërmjet Inspektoratit të Arsimit, DKA-ve dhe shkollave; 2) trajnimit të inspektorëve të shkollave, si dhe personelin përgjegjës të DKA-ve dhe shkollave në rolin e tyre në kuadër të sistemit të Sigurimit të Cilësisë 3) Zhvillimi i kornizës së vlerësimit dhe treguesit 4) Publikimi i rezultateve të vlerësimit të jashtëm	DKA-të krijojnë ekipe komunale për të mbështetur Sigurimin e Cilësisë në shkolla  Shkollat kanë vendosur menaxhment efektiv të nivelit të mesëm dhe kanë emëruar koordinatorët për Sigurimin e Cilësisë.	Llogaridhënie dhe transparencë të përmirësuar në kuadër të Sistemit të Arsimit.
<b>Kostoja e përlogaritur: 10.5 mil. €</b>	Fuqizimi i vlerësimit të jashtëm të studentëve përmes:  1) Digjitalizimit të sistemit të testimit 2) Analizimit të rezultateve kombëtare të vlerësimit 3) Analizimit të rezultateve të PISA		

Në një strukturë të tillë, duhet të zhvillohen/fuqizohen kapacitetet dhe stimulimet për shkolla për kryerjen e funksionit të tyre të Sigurimit të Cilësisë. Për shembull, shkollat duhet të prezantojnë sistemet e brendshme të sistemit të cilësisë (që mund të standardizohet) dhe përgjegjësitë për menaxhimin e tyre mund të ndahen në mesin e personelit të shkollës. Është me rëndësi që shkollat krijojnë dhe

.....

mirëmbajnë strukturë menaxhuese të nivelit të mesëm në formën e departamenteve përgjegjëse për fusha të caktuara të kurikulës. Me përmirësimin e kapaciteteve të shkollave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, natyrshëm pason një rolë më i madh i komunave, prindërve dhe shkollave. Në këtë rast, komunat do të kenë rol udhëheqës në sigurimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit në institucione të cilat janë nën përgjegjësinë e drejtpërdrejt të tyre, ndërsa MASHT përmes Inspektoratit të Arsimit do të vepronte si një mekanizëm i jashtëm i sigurimit të cilësisë, duke kryer vlerësime të jashtme në mënyrë periodike. Kjo është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe duket të jetë rruga më e përshtatshme për të ndërtuar një sistem efektiv të Sigurimit të Cilësisë në vend.

#### **Masa 4: Përmirësimi i burimeve të edukimit dhe integriti i TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie**

E shfrytëzuar për të përkrahur të dy aspektet, mësimdhënien dhe mësimnxënien, Teknologjia Informative dhe Komunikimit plotëson klasat me mjete digjitale të të mësuarit, sikurse kompjuter dhe pajisje të dorës; zgjeron ofertat, ndërveprimin dhe përvojën e kursit dhe materialet e të mësuarit; ndërton shkathtësi të shekullit 21; rrit angazhimin dhe motivimin e nxënësve; bënë shkollën prapë atraktive; dhe nxit të mësuarit. Promovimi i shfrytëzimit të TIK në shkolla është mënyra më e mirë për të siguruar fëmijëve dhe studentëve me teknologjinë e munguar arsimor dhe lehtësirave të mësimdhënies, dhe të motivojë ata në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Studentët shfrytëzojnë pajisje të TIK-ut për të gjetur, korigjruar, analizuar, ndryshuar dhe prezantuar informata në mënyrë të duhur dhe kreative. Teknologjia mund të zëvendësojë tekstet shkollore dhe ofroj burime të pakufizuara për të lehtësuar të mësuarit. Rritja e kapaciteteve për shfrytëzimin e pajisjeve të TIK-ut mbështetet iniciativat dhe të mësuarit e pavarur të studentëve dhe i mundëson atyre të arrijnë konkluzione të vlefshme në mënyrë të pavarur si dhe të kenë parasysh implikimet e shfrytëzimit të TIK-ut në shtëpi dhe punë. Në vendet e zhvilluara kompjuterët shfrytëzohen në klasa për dekada dhe kohëve të fundit shkollat kanë filluar të përshtatin teknologjinë si një pjesë e pandashme, natyrore e mësimdhënies dhe të mësuarit. Prandaj, ideja është që të furnizohen të gjitha shkollat me TIK dhe ta shfrytëzojnë atë për përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Gjatë planifikimit të infrastrukturës së TIK-ut në shkolla duhet të kihet parasysh se TIK mundëson shfrytëzim më efikas të teknologjive dhe pajisjeve të tjera arsimore, dhe redukton koston për lëndët arsimore të varura nga teknologjia dhe lehtësirat e mësimdhënies, sikurse: laboratorë të specializuar provash; harta, dhe të tjera. Për këtë arsye, duhet të konsiderohet me rëndësi pajisja e të gjitha ose një numri të klasave me video-projektor (monitor) dhe të sigurohen në shkolla një numër kompjuterësh portativ (laptop) për mësimdhënës të cilët shfrytëzojnë teknologjinë në punën e tyre dhe në punën me student, që ndërlikohet shumë mirë me reformën e tanishme të kurikulës dhe pritet që shkollat të vendosin për përmbajtjen e mësimdhënies, materialet dhe qasjet pedagogjike. Kjo mund të kombinohet mjaft mirë me burimet e disponueshme për nxënësit: telefona mobil, tableta dhe të tjera.

Mirëmbajtja është një aspekt shumë i rëndësishëm për funksionim të qëndrueshëm të tërë sistemit. Shërbimet e mirëmbajtjes mund të sigurohen përmes trajnimit të personelit të shkollës dhe përmes motivimit nxënësve (sikurse klubet e shkollës për kompjuter, etj.), duke kontraktuar kompani të tjera në nivel të shkollës ose nivel komunal, duke rekrutuar ekspert dhe duke siguruar shërbime të mirëmbajtjes në forma të tjera (donacione). Sigurimi i qasjes në internet dhe vendosja e infrastrukturës së rrjetit në shkolla është një parakusht për shfrytëzim efektiv dhe efikas të TIK-ut. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit dhe studentët përfitojnë nga qasja në burime të ndryshme online dhe kanë mundësi të bëjnë aplikim të atypëratyshëm të ideve dhe përvojave nga një numër i madh i njerëzve, komuniteteve dhe kulturave. Kjo mund të pasohet me mundësimin e burimeve online të mësimdhënies dhe të mësuarit e cila në kombinim me teknologjinë e duhur mund të zëvendësojë teknologjinë e shtrenjtë arsimor. Gjithashtu, mësimdhënësit duhet të motivohen në zhvillimin dhe ndarjen e materialeve të tyre të përshtatshme për tu shfrytëzuar me TIK.

.....

Iniciativa e TIK-ut mund të zbatohet në pilot projekte të vogla dhe duhet të siguroj që të gjitha pajisjet e TIK-ut dhe lehtësirat e mësimdhënies janë të siguruar njëkohësisht. MASHT mund të kërkoj pjesëmarrjen e operatorëve kombëtar të internetit dhe kompani ndërkombëtare të kompjuterëve për të reduktuar koston. Ministria ka nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit me Microsoft për softuer arsimor falas dhe iniciativa të ngjashme mund të konsiderohen me kompani të tjera të mëdha. Strategjia për zbatimin e TIK-ut mund të përcaktoj sigurimin e gjërave në vijim:

Tabela 17 – Burimet e edukimit dhe integrimi i TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Artikujt	Numri	Kostoja për njësi	Totali në milion
Lidhja me internet	600 shkolla		
Kompjuter	8000	300 Euro	2,4
Laptop për mësimdhënës	7500	400	3
Kupona laptopi për student (shkollat profesionale teknike)	20,000	200	4
Video-projektor	1500	1000	1,5
LCD Smartboard	20,000	500	1
Shtypës	1500	1000	1,5
Trajnim për mësimdhënës	5000		1
Mirëmbajtja			0.6

Tabela 18 – Masa e politikave #1.1.4

	Aktiviteti	Produkti	Rezultati
<b>Masa e politikave #1.1.4</b> <i>Promovimi i shfrytëzimit të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit në mësimdhënie dhe mësimnxënie</i>	<i>Promovimi i shfrytëzimit të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit në mësimdhënie dhe mësimnxënie përmes:</i> 1) Sigurimi i pajisjeve të TIK-ut për tu shfrytëzuar në klasa 2) Sigurimi i qasjes në internet dhe rrjetin e brendshëm të shkollës; 3) Sigurimi i qasjes në burime online të mësimdhënies dhe të mësuarit 4) Vendosija e ofrimit të mirëmbajtjes për mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut.	Të gjitha shkollat në Kosovë kanë qasje në internet Ekziston së paku një kompjuter funksional për dhjet nxënës në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës TIK dhe/ose burimet online shfrytëzohen në së paku 40% të klasave në shkolla Të gjithë nxënësit në shkollat teknike profesionale (TIK) janë të pajisur me laptop Të gjitha shkollat janë të pajisura me video-projektor dhe shtypës Rreth 5000 mësimdhënës të rinj janë trajnuar në TIK	Zbatim i suksesshëm i Kurikulës së re të Kosovës  Rezultate të përmirësuara të nxënësve në vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.
<b>Kostoja e përlogaritur:</b> 15 mil. €			



## Tabela e figurave

Figura 1 - Përçindja e përmirësimit të inputeve të arsimit dhe arritshmëria e nxënësve.....	11
Figura 2 – PISA 2012 - parashikim .....	12
Figura 3 - Shkalla e kalimit të provimit të maturës sipas viteve 2008-2014.....	12
Figura 4 - Vijueshmëria e përgjithshme në të gjitha nivelet e arsimit 2008-2014.....	13
Figura 5 – Numri i studentëve para-universitar dhe trendet e financimit.....	15
Figura 6 – Grupmoshat e mësimit të mesëm – krahasim.....	18
Figura 7 – Kualifikimet e mësimit të mesëm.....	19
Figura 8 - SHBR në arsimin para fillor dhe atë fillor 2008-2014 .....	25

## Lista e tabelave

<b>Tabela 1 - Çfarë bëjnë sistemet e avancuara të arsimit për të përmirësuar performancën?.....</b>	<b>9</b>
Tabela 2 – Struktura e arsimit në Kosovë.....	11
Tabela 3 – Statistikat kyçe të arsimit të obliguar në Kosovë.....	13
Tabela 4 - Regjistrimi bruto në arsim (GER) – Krahasimi rajonal 2014.....	14
Tabela 5 - Shpenzimet (në milion Euro) në arsim e shprehur në indikator standard dhe nën-sektorial 2011-2014 .....	15
Tabela 6 – Kosovë: Grup moshat e mësimit të mesëm 2014.....	18
Tabela 7 - Kuadri i mësimit të mesëm sipas gjinisë.....	18
Tabela 8 - Të ardhura mesatare vjetore të mësimit të mesëm krahasuar me BPV vjetore për kokë banori, 2013.....	22
Tabela 9 - Të rritet përfshirja në arsimin para-fillor me 5000 fëmijë shtesë.....	26
Tabela 10 - Të rritet përfshirja në arsimin para-shkollor (3-4 vjeçare) me 5000 fëmijë shtesë.....	26
Tabela 11 – Masa e politikave #1.1.1 .....	26
Tabela 12 – Iniciativa për shfrytëzimin optimal të mësimit të mesëm.....	27
Tabela 13 - Skema e pensionimit të hershëm të mësimit të mesëm me aftësi të kufizuara.....	28
Tabela 14 – Skenari 1: Implikimet vjetore të kostos për sistemin e licencimit të mësimit të mesëm.....	29
Tabela 15 – Masa e politikave #1.1.2 .....	29
Tabela 16 – Masa e politikave #1.1.3 .....	30
Tabela 17 – Burimet e edukimit dhe integrimi i TIK në mësimit të mesëm dhe mësimit të mesëm.....	32
Tabela 18 – Masa e politikave #1.1.4 .....	32

.....

## Referencat

AKK (2013), Plani Strategjik i Kolegjiumit të Arsimit 2013-2016. Asociacioni i Komunave të Kosovës, Prishtinë.

Anastasoska-Jankulovska, M. (2013), Edukimi dhe Trajnimi i Mësimdhënësve në Ballkanin Perëndimor, Raporti për Kosovën. Bashkimi Evropian

Anastasoska-Jankulovska, M. (2013b), Edukimi dhe Trajnimi i Mësimdhënësve në Ballkanin Perëndimor, Raporti për Maqedoninë. Bashkimi Evropian

Asunta, T., Bratengeyer, E., Havu-Nuutinen, S. (2010), Raport vlerësues, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit. KAA, 11 qershor 2010. Publikuar në: [http://ëëë.akreditimi-ks.org/?doëload=FR%20UP%20FoEdu%202010%20\(e\).pdf](http://ëëë.akreditimi-ks.org/?doëload=FR%20UP%20FoEdu%202010%20(e).pdf)

Clifford-Amos, T. (2013), Edukimi dhe Trajnimi i Mësimdhënësve në Ballkanin Perëndimor, Raporti për Bosnje dhe Hercegovinë. Bashkimi Evropian

Clifford-Amos, T. (2013b), Edukimi dhe Trajnimi i Mësimdhënësve në Ballkanin Perëndimor, Raporti për Malin e Zi. Bashkimi Evropian.

Komisioni Evropian (2013), Studimi në Shkolla: TIK në Edukim.

Komisioni Evropian/EACEA/Eurydice, 2015. Sigurimi i Cilësisë në Arsim: Politikat dhe qasje në Vlerësimin e Shkollave në Evropë. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union

Komisioni Evropian/EACEA/Eurydice, 2013. Të dhëna kyce për mësimdhënësit dhe Liderët e Shkollave në Evropë. Botimi 2013. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2014), Statistikat e Arsimit 2012/13. Prishtinë

Ligji (2002), Ligji për Arsimin fillor dhe të mesëm. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.

Law (2004), Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.

Ligji (2011), Ligji Nr. 04/L-032 mbi arsimin para-universitar në Republikën e Kosovës. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.

MASHT (2001), Korniza e Kurikulës së Kosovës. Prishtinë, Kosovë: Departamenti i UNMIK për Arsim.

MASHT (2010), Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2010 për kriteret dhe procedurat për akreditimin e programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2010b), Udhëzimi Administrativ Nr. 5/2010 për licencimin e mësimdhënësve. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2011), Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2011b), Korniza e re Kurikulës së Kosovës. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2011c), Katalogu i Programeve të Akredituara për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Lidërsip Arsimor. Prishtinë: EU Education SWAp Project.

.....

MASHT (2012), Vendimi Nr. 191/01B i Ministrisë të Arsimit Shkencës dhe teknologjisë i datës 16/07/2012. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2013), Indikatorët e Arsimit në Kosovë 2009/10, 2010/11, 2011/12. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2013b), Statistikat e Arsimit në Kosovë 2012/13. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2013c), Udhëzimi Administrative Nr. 14/2013 mbi Vlerësimin e performancës së Mësimdhënësve. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2014), Statistikat e Arsimit në Kosovë 2013/14. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MASHT (2014b), Udhëzimi Administrativ Nr. 25/2014 për licencimin e mësimdhënësve. Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Ministria e Shoqërisë Informativë dhe Administratës (2014), Kompjuter për secilin student. Qasja nga: <http://www.mio.gov.mk/?q=node/1975> më 21 nëntor 2014.


OECD (2001), Shqyrtim tematik i Politikave Kombëtare të Arsimit – Kosovë. Publikuar në: [http://www.see-educoop.net/education\\_in/pdf/thematic-review-kosovo-yug-kos-enl-t05.htm](http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/thematic-review-kosovo-yug-kos-enl-t05.htm)

OECD (2014), Rezultatet Talis 2013: Një perspektivë ndërkombëtare për mësimdhënie dhe mësimnxënie, Publikim i OECD. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264196261-en>

Von Zallinger, L. (2014), Strategjia e Kosovës për Teknologji Informativë. Prishtinë: Asociacioni i Kosovës për Teknologji Informativë dhe të Komunikimit.

Banka Botërore (2014), Rishikimi i Financave publike të Kosovës. Report No: ACS9351.

Grupi i Bankës Botërore (2014), Pasqyrim i Vendit – Kosova. Prishtinë: Zyra e Bankës Botërore në Kosovë.



## KU MUND TË MARRIM MË TEPËR INFORMATA?

Procesi i përgatitjes së PLAN-it është koordinuar nga  
Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit.

Për më tepër informata mund të kontaktoni në:  
[info@plan-rks.org](mailto:info@plan-rks.org)

[www.plan-rks.org](http://www.plan-rks.org)